

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P Nr. 64/2005

30 nëntor 2009

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Trup Gjykses të përbërë nga:

Gjykatës nga EULEX, Z. Francesco Florit, Kryetar i Trupit Gjykses,
Gjykatës vendor, Znj. Marije Ademi,
Gjykatës nga EULEX, Mr.Dragomir Yordanov,

Me Proces-mbajtëse Znj. Patricia Faltusova,

Në lëndën penale kundër:

1). **Avni OSMANIT**, i bir i Ademit dhe Hases, emri i vajzërisë Bërbatovci, i lindur më 24.05.1983, në fshatin Sllatinë e Madhe, komuna Fushë Kosovë, ku edhe jeton, shqiptar nga Kosova, i papunësuar, ka kryer shkollën e mesme, në kushte të mira ekonomike, në paraburgim që nga 29 tetori 2004 i ngarkuar me veprën penale vrasje e rëndë në pajtim me Nenin 147, paragrafi 1, pikët 3, 7 dhe 8 lidhur me Nenin 23, KPK.

2). **Fitim BREZNICA**, i biri i Rexhepit dhe Fatimes, emri i vajzërisë Bërbatovci, i lindur më 10.10.1979, në Prishtinë, me vendbanim në fshatin Bardh i Madh, komuna Fushë Kosovë, shqiptar nga Kosova, i papunësuar, ka kryer shkollën e mesme, në kushte të mesme ekonomike, në paraburgim që nga 30 prill 2005, i ngarkuar me veprën penale vrasje të rëndë në pajtim me Nenin 147, paragrafi 1, pikët 3, 7 dhe 8 lidhur me Nenin 23, KPK.

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më 4, 22, 29 qershor dhe 10, 11, 13 gusht, 1 shtator, 10, 24 dhe 30 nëntor 2009, në praninë e prokurorit publik Z. Osman Mehmeti, të akuzuarit dhe avokatët e tyre mbrojtës Z. Fadil Hoxha (për Z. Avni Osmani) dhe Z. Vahid Halili (për Z. Fitim Breznica), shpallet publikisht:

AKTGJYKIM

1) **Avni Osmani** shpallet fajtor

Për veprën penale vrasje të rëndë në pajtim me Nenin 147, paragrafi 1, pikët 3 dhe 8, KPK.

Name: Aktgjykim
Job Number: A - 980

Translated by: Phone:
EL
SC

Page: 1 of 31

2) **Fitim Breznica** shpallet fajtor

Për veprën penale të dhënies së ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale në pajtim me Nenin 305, paragrafi 3, KPK.

Sepse:

1) **Avni Osmani**

Më 28 tetor 2004 gjatë mbrëmjes i pandehuri Avni Osmani në fshatin Bardh i Madh, komuna Fushe Kosove, në vendin e quajtur "Te Kalaja" në mënyrë mizore apo dinake dhe me qëllim të fshehjes së një vepre tjetër penale së mashtrimit me revolver të llojit të padefinuar, të kalibrit 9x19mm, me dashje privoi nga jeta të ndjerin Kastriot Zogianin, 20 vjeçar, nga fshati Halilaq, duke shtënë 12 herë në trupin e tij, nga të cilat 10 ishin lëndime nga të shtëna armësh ndërsa dy të tjera nga armë zjarri, me shënjestër kryesisht në pjesën spinale të trupit, me ç'rast lëndimet shkaktuan vdekjen e viktimës, verifikuar në raportin e autopsisë të datës 24 dhjetor 2004, lëndime nga të cilat Kastriot Zogiani vdiq menjëherë dhe trupi i pajetë u fsheh në një vrimë të madhësisë 3.40m.x4.80m, të mbuluar me ujë dhe me qese plastike dhe dhe.

2) **Fitim Breznica**

Më 28 tetor 2004 gjatë mbrëmjes, i pandehuri Fitim Breznica i dha ndihmë të pandehurit Avni Osmani pas kryerjes së veprës penale të përshkruar më lart duke e ndihmuar atë për t'u shmangur zbulimit të veprës së përmendur duke fshehur trupin e pajetë e të ndjerit Kastriot Zogiani në vrimën me madhësi prej 3.40m.x4.80m, të mbushur me ujë dhe të mbuluar me qese plastike dhe duke fshehur armën me të cilën është kryer vepra penale duke e hedhur atë në lumin Drenica.

DËNIMI

1.) **Avni Osmani**

Në pajtim me Nenin 37 të Kodit Penal të Kosovës dhe Neni 147, paragrafi 1, pikët (3) dhe (8) dënohet me burgim prej 30 (tridhjetë) vjetë;

Koha e kaluar në paraburgim që nga 29 tetor 2004 deri në plotfuqishmërinë e vendimit do të llogaritet si pjesë e dënimit të burgimit në pajtim me Nenin 73, KPK

2) **Fitim Breznica**

Në pajtim me Nenin 37 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenin 305, paragrafi 3 dënohet me burgim prej 4 (katër) vjetë dhe 7 (shtatë) muaj;

Koha e kaluar në paraburgim që nga 30 prill 2005 deri në plotëfuqishmërinë e vendimit do të llogaritet si pjesë e dënimit të burgimit në pajtim me Nenin 73 KPK

Trupi Gjykses urdhëron paraburgimin e të pandehurit Avni Osmani deri në plotëfuqishmërinë e vendimit me efekt të menjëhershëm.

Trupi Gjykses urdhëron ndërprerjen e paraburgimit të pandehurit Fitim Breznica me plotëfuqishmëri me efekt të menjëhershëm.

SHPENZIMET

Në pajtim me Nenin 102, paragrafi 1, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), personat e gjykuar do të paguajnë bashkërisht shpenzimet e procedurës në shumën prej 400 Euro.

ARSYETIMI

Historiku procedural

Aktakuza kundër të gjykuarve u ngrit më 26 tetor 2005 në Gjykatë.

Aktakuza u konfirmua me vendimin e Gjykatës Selman Bogiqi më 29 nëntor 2005, pas dëgjimit të avokatëve mbrojtës të të akuzuarve gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës.

Shqyrtimi kryesor kundër të akuzuarve filloi më 20 mars 2006 me Trup Gjykses të përbërë nga gjykatës vendorë dhe gjykatës porotë. Pas formaliteteve fillestare dhe leximit të aktakuzës nga prokurori, filloi dëgjimi I dëshmitarëve.

Shqyrtimi kryesor është shtyer deri më 21 mars, 27 prill, 7 qershor, 17 korrik, 4 shtator, 9 tetor, 9 nëntor, 13 nëntor, 18 dhjetor 2006, 17 janar 2007, 5 mars, 23 prill, 4 qershor, 25 qershor, 20 shtator, 22 tetor, 27 nëntor, 17 dhjetor 2007, 6 mars 2008, 7 prill, 26 maj, 24 qershor 2008.

Për shkak të padisponueshmërisë së paritur të Kryetarit të Trupit Gjykses, shqyrtimi kryesor nuk përfundoi dhe shqyrtimi kryesor është dashur të rifillojë me Kryetar të ri të Trupit Gjykses, Znj. Marije Ademi.

Disa herë, Avni Osmani kërkoi që gjykimi të bëhej nga gjykatësit ndërkombëtarë. Kërkesat e drejtuar trupit Gjykses dhe Gjykatës Ndërkombëtar Kryesor të UNMIK-ut nuk janë pranuar.

Përfundimisht, më 12 nëntor 2008, kërkesa i është përsëritur Trupit të ri Gjykses, të kryesuar nga Znj. Marije Ademi. Kur kërkesa është ushtruar nga Avni Osmani, Fitim

Bresniza dhe avokati i tij mbrojtës nuk kundërshtuan kërkesën përderisa Kryetari i Trupit Gjykses e mbështeti.

Ç'është e vërteta, Kryetari i Trupit Gjykses me anë të letrës së datës 5 shkurt 2009 e përcolli kërkesën Kryetarit të Gjykatës, i cili e aprovoi atë dhe e drejtoi Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it më 17 prill 2009.

Pas kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Qarkut dhe në pajtim me Nenet 3.4, 3.6 dhe 4.3 Ligjit mbi Juridiksionin, Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, Znj. Giuliana Civinini nxorri vendimin e datës 24 prill 2009 që i cakton lëndën një trupi gjykses me shumicë gjykatës nga EULEX.

Shqyrtimi kryesor vazhdoi më 4 qershor 2009 në praninë e Prokurorit, Z. Osman Mehmeti, dy të akuzuarve dhe avokatëve të tyre mbrojtës (Miodrag Brkljac për Avni Osmani dhe Haki Lecaj dhe Vahid Halili për Fitim Breznica).

Avokatët mbrojtës të Fitim Breznica ushtroi kërkesë për përjashtimin e gjithë trupit gjykses. Kërkesa nuk ishte e bazuar në arsye specifike për përjashtimin e një apo më shumë gjykatësve individualë, *p.sh.* Neni 40 dhe 42, KPPK, por ishte e bazuar në një deklaratë gjenerike preference dhe besimi në gjyqësinë vendore dhe në konsiderimin se me praninë e "ndërkombëtarëve do të kishte komplikime për shkak të përkthimit dhe asaj që futet në proces-verbal për shkak se ne pranojmë proces-verbalin e përkthyer 10-20 ditë më vonë dhe përballemi me shumë vështirësi të tjera"¹.

Kërkesa është refuzuar si e papranueshme për shkak se vendimi i Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it për të emëruar gjykatës nga EULEX në trup gjykses shprehimisht kualifikohet si e plotfuqishme dhe nuk i nënshtrohet asnjë mjeti nga Ligji mbi Juridiksionin e Gjykatësve nga EULEX nr. 03/L-053 (Neni 3.6, pjesa e fundit: "ndaj këtij vendimi, i detyrueshëm për të gjitha autoritetet e Kosovës, nuk lejohet ankesë"). Trupi Gjykses i njëjtë mori vendimin duke vënë re se kërkesa e avokatëve mbrojtës nuk i është drejtuar përjashtimit të gjykatësve për një ndër arsyet e renditura në Nenin 40, KPPK dhe si e tillë, kompetencë e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut *p.sh.* Neni 43, KPPK nuk ishte e zbatueshme.

Pas shpalljes së vendimit, seanca vazhdoi me formalitetet paraprake të parapara me ligj (identifikimi i të akuzuarve, verifikimi i pranisë së palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, leximi i aktakuzës, pranimi i fajësisë). Pastaj, u vazhdua me ekzaminimin e dëshmitarit të parë, Mehush Zogiani.

Gjatë seancave në vazhdim, u dëgjuan dëshmitarët si në vijim:

Më 22 qershor 2009 dëshmitarët Mehush Zogiani sërish dhe Myrvete Breznica.

¹ Proces-verbal i seancës 4 qershor 2009, faqe 2.

Më 29 qershor 2009 dëshmitarët Shefki Zogiani, Orhan Zogiani, Mynavere Gerguri dhe Lulzim Breznica.

Më 10 gusht 2009 dëshmitarët Hasime Osmani, Fatmir Godeni, Bekim Sllamniku dhe Shukri Sllamniku.

Më 11 gusht 2009 dëshmitarët Bujar Gashi, Sinan Qeriqi, Flakron Bajgora dhe Naser Meziu.

Më 13 gusht 2009 dëshmitarët Shamsi Jashari, Azem Muzhaku dhe dëshmitari ekspert Dr.Tefik Gashi.

Më 1 shtator 2009 dëshmitarët ekspertë Dr.Tefik Gashi dhe Hazir Kelmendi; dhe pas administrimit të provat materiale, filloi ekzaminimi i Fitim Breznicës.

Më 10 nëntor 2009 është ekzaminuar Avni Osmani.

Trupi Gjykses dëgjoi fjalët përfundimtare të prokurorit publik, të avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarve më 24 nëntor 2009.

Së fundi, më 30 nëntor 2009, Trupi Gjykses shpalli vendimin.

Të gjeturat ligjore dhe faktike.

Në fillim të kësaj pjese të vendimit, është e rëndësishme të kujtohen disa aspekte të shqyrtimit kryesor i tillë siç u shpalos ngase mund të kontribuojnë për të hedhur dritë në rastin në fjalë dhe për të parë faktet në një perspektivë më të mirë.

Pika e parë është kohëzgjatja abnormale e procedurës kundër të akuzuarit.

Avni Osmani dhe Fitim Breznica kanë pritur në burg përfundimin e shqyrtimit kryesor kundër tyre për pothuajse pesë vjetë.

E vërtetë se shqyrtimi kryesor filloi njëherë por nuk arriti në përfundojë në mënyrë normale për shkak se Kryetari i Trupit Gjykses Hoxha u largua nga aktivitetet gjyqësore për arsye personale.

Shqyrtimi Kryesor filloi nga fillimi me një trup gjykses të ri të përbërë nga gjykatës vendorë profesionistë dhe gjykatës porotë vendore, kryesuar nga Znj.Marie Ademi. Por edhe atëherë pas një shtyerje të vetme disa muajshe, është suspenduar për shkak të kërkesës së të akuzuarit për gjykim nga trup gjykses nga EULEX.

Prandaj, duket se vendimi i Kryetarit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, i datës 24 prill 2009 dhe i motivuar me shtyerjet e mëdha dhe kohëzgjatjen e padurueshme të paraburgimit para shqyrtimit kryesor ishte vendim i bazuar dhe i menqur.

Ishte pra befasi kur që në fillim të seancës më 4 qershor 2009, avokati mbrojtës i Fitim Breznicës, Z.Haki Lecaj, kundërshtoi fuqimisht emërimin e gjykatësve të EULEX me pretendimin se prania e gjykatësve ndërkombëtarë do të sjellte “komplikime” dhe “shumë pengesa të tjera” në procedurë. Ngatërresat dolën në sipërfaqe kur u sugjerua zgjidhja subsidiare (në rast se kërkesa për rrimërimin e trupit gjykues vendor do të refuzohej) se gjykatësit ndërkombëtarë janë emëruar si anëtarë të trupit gjykues dhe një gjykatës vendor që mban funksionin e Kryetarit të Trupit Gjykues. Ngatërresat përcaktohen sigurisht jo nga fakti se pozita e Kryetarit të Trupit Gjykues mund t’i jepet një vendori (një zgjedhje e tillë do të ishte në kundërshtim me dispozitën e Nenit 3.7, pjesa e parë, të Ligjit mbi Juridiksion) por me observimin e qartë se prania e një gjykatësi vendor si kryetar të trupit gjykues nuk do të kishte shmangur nevojën e interpretimit në gjykatë dhe përkthimit të proces-verbalit.

Në këtë pikë, është e rëndësishme të qartësohet akoma më shumë se sjellja e avokatëve mbrojtës gjatë seancave të shqyrtimit kryesor asnjëherë nuk kanë qenë të brengosur lidhur me çështjen e vonesave. E gjithë dosja nuk përmban asnjë kërkesë, me shkrim apo me gojë, e cila mund të interpretohet si kërkesë për të përshpejtuar shqyrtimin kryesor apo si manifestim të mospajtimit me mënyrën se si shqyrtimi kryesor është zgjatur jashtë përmasave të normales.

Për më tepër, avokatët e njëjtë, të cilët më 4 qershor 2009 u ankuan lidhur me emërimin e anëtarëve ndërkombëtar të Trupit Gjykues, ishin të pranishëm në seancën e mbajtur më 12 nëntor 2008.

Që ditën e njëjtë, shqyrtimi kryesor rifilloi me Znj.Marije Ademi në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues, pas pensionimit të kryetarit të mëparshëm, Z.Hoxha. Atë ditë, i pandehuri Avni Osmani kërkoi që lënda t’u referohet “gjykatësve ndërkombëtarë” dhe avokati i tij mbrojtës, i emëruar nga gjykata Z.Ali Beka, mbështeti kërkesën e tij. Në këtë bazë, Trupi Gjykues vendosi të ndërpresë seancën në pritje të vendimit lidhur me caktimin e lëndës gjykatësve ndërkombëtarë. Sërish, as Z.Lecaj e as Z.Vahidi nuk reagueshan ndaj kërkesës. Ata mbetën plotësisht të heshtur dhe as në fazë të mëvonshme nuk shprehën kundërshtimin e tyre.

Atëherë në çfarë përfundimi duhet të arrihet lidhur me sjelljet e avokatëve mbrojtës, të cilët prezantuan kërkesën e tyre për ricaktimin e lëndës gjykatësve vendorë në fillim të seancës më 4 qershor 2009, gati pothuaj shtatë muaj mungesë aktiviteti?

Në një situatë të tillë, a mund të konsiderohet preokupimi i tyre për një shqyrtim të përshpejtuar dhe zgjedhje të shpejt si serioz? Në të vërtetë, Trupi Gjykues është i mendimit se nuk mund të konsiderohet i tillë dhe se kërkesa e ushtruar në fillim të seancës më 4 qershor 2009 për zëvendësimin e gjithë anëtarëve të Trupit Gjykues ishte krejtësisht e pabazuar

Një përpjekje kundër parimit të gjykatësit si gjykatës, i përcaktuar nga ligji, një rast *forum shopping* në çështje penale.

Një tipar tjetër është sjellja e Avni Osmanit në gjykatë dhe jashtë saj.

Në këtë pikë, Trupi Gjykses nuk i referohet ndryshimit të vazhdueshëm të versioneve, të cilat do të diskutohen më vonë dhe kjo do të zbulojë një pjesë të karakterit të tij.

Këtu i referohet ndryshimit të vazhdueshëm të avokatëve gjatë seancave, pikëllimit të gjendjes psikologjike të paqëndrueshme, çrregullimeve të shkaktuara në qendrën e paraburgimit, dhe në përgjithësi tendencës së pakontrollueshme ndaj polemikës, gjë për të cilën i njëjti Kryetar i Trupit Gjykses, kërkoi të të akuzuarit në disa raste që të silltet mirë.

Avni Osmani ka ndërruar disa avokatë mbrojtës gjatë seancave të shqyrtimit kryesor.

Fillimisht i mbrojtur nga Z.Tmava, pastaj nga avokati Z.Ali Beka i caktuar nga gjykata kur Z.Tmava hoqi dorë nga mbrojtja e tij.

Në seancën e rradhës, Z. Miodrag Brkljac përfaqësoi mbrojtjen e Avni Osmanit. Ishte paraqitje e shkurtër ngase qysh në seancën tjetër, Z.Fadil Hoxha e zëvendësoi atë. Pra edhe ky i fundit kishte telashet e tij me marrëdhënien e tij profesionale me klientin e tij, i cili për shkak të fodullëkut dhe mungesës së vetë-përmbajtjes vazhdimisht kufizonte rolin e avokatit mbrojtës. Kjo ishte në nivel kaq të lartë sa që ishte e nevojshme që Trupi Gjykses t'i referohet Nenit 76, KPPK dhe të emërojë Z.Visar Vehapi (seanca më 11 gusht 2009). Si lëvizje e fundit, edhe avokati i emëruar zyrtarisht u zëvendësua shumë shpejt kur Z.Fadil Hoxha iu kthye mbrojtjes së Avni Osmanit.

Tani, është vërtetim i qartë se i akuzuari ka të drejtë të ndërrojë avoaktin mbrojtës sa herë që është i mendimit se diçka e tillë është e nevojshme dhe se gjykatësi nuk ka mundësi ta ndalojë një gjë të tillë.

Mirëpo, do të ishte e gabuar të mbyllet një sy mbi këtë fakt dhe qëllimisht të injorohet. Më e pakta, gjykata duhet ta konsiderojë si indikator të pranisë së një problemi, p.sh. të karakterit të të akuzuarit apo të një mbrojtje problematike.

Kjo shihet qartë në sjelljen e të akuzuarit në gjykatë, i cili është kërkuar disa herë të përmbahet dhe të ndërpresë të folurit e pakontrolluar. Më 11 gusht 2009 ai refuzoi të sjellet në gjykatë dhe është dashur që fizikisht të detyrohet të shkojë te drejtori i qendrës së paraburgimit në Dubravë me urdhër të Kryetarit të Trupit Gjykses. Pastaj, pas sjelljes së tij në gjykatë, ai filloi të ndërpresë dhe të pengojë shqyrtimin kryesor²; është dashur të

² Faqe 2 e proces-verbalit: "Kryetari i Trupit Gjykses dëshmitarët Bujar Gashi: "Tani, përgjigjuni në pyetjet e Prokurorit Publik. Primi, Avni Osmani, Ju thashë se nuk keni të drejtë të flisni tani. Ju dëgjuam dhe. Tani, uleni dorën dhe dëgjoni dëshmitarin. Avni Osmani: Kundërshtoj këtë dhe dua të bëj një kërkesë. Kryetari i Trupit Gjykses: Nëse keni kërkesë ta bëni atë nëpërmjet avokatit tuaj. Nuk është çasti për kërkesat e juaja. Avni Osmani: Pra, ky gjykim kundër meje do të mbahet kundër vullnetit tim.

largohet nga salla e gjykimit në pajtim me Nenin 336, KPPK; ai u pranua në sallë të gjykimit në seancën e radhës, por vazhdoi të përsërisë sjelljen e tij kohë pas kohe. Një sërë rastesh të tjera, ai insistonte të përsërisë kërkesa të cilat janë refuzuar nga Trupi Gjykses më parë (mbi zëvendësimin e prokurorit publik me prokuror ndërkombëtar). Shpesh herë, është kërkuar që të ulet, të qetësohet dhe të mos ndërpresë më seancën.

As marrëdhëniet me avokatët nuk ishin më pak problematike, siç u pa më lart dhe siç është dëshmuar me anë të proces-verbalit të seancës së mbajtur më 11 gusht 2009, e cila shumë qartë tregon se çfarë lloj marrëdhënie Osmani deshi të themelojë me avokatët e tij.³

Këto shenja personaliteti 'shpërthyes' dalin edhe nga dosja e tij në qendrën e paraburgimit, ku raportohet se ka shfaqur mungesë respekti dhe bindjeje ndaj rregullave dhe rojeve të burgut (shih 1. sanksionet disiplinuese e kërkuara për këtë arsye nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë më 31 korrik 2006; 2. vendimi disiplinues nga Kryetari i Trupit Gjykses më 12 prill 2006; 3. Komunikimi nga Sherbimi Korrektues i Kosovës më 7 gusht 2009 mbi posedimin dhe konfiskimin e një telefoni mobil nga qelia e Osmanit; 4. komunikimi i datës 21 gusht 2009 për shkelje të tjera).

Personaliteti i tillë i Avni Osmanit ilustron edhe me insistimin e të akuzuarit për t'u gjykuar nga gjykatës ndërkombëtarë, me një mori letrash (dhe me fillimin e regjimit me grevë urie, shih komunikimet e Sherbimit Korrektues të Kosovës të datës 20 mars 2008) dërguar Z.Vinod Boolel dhe autoriteteve të tjera të UNMIK-ut në mënyrë që një gjykatës ndërkombëtar t'i caktohet lëndës.

Kur në fund u pranua kërkesa e tij me vendimin e Znj.Giuliana Civinini, i akuzuari zhvendosi përqëndrimin e tij te kërkesa për të caktuar prokuror ndërkombëtar .

Në linjën e njëjtë, marrëdhënia në gjykatë ne më dy të akuzuarve ishte kaq qartazi e ndikuar nga superioriteti intelektual i Avni Osmanit dhe ngadalësia dhe ndikueshmëria e lehtë e Fitim Breznicës, saqë fjala nënshtim nuk do të ishte e duhur. Superioriteti i tillë mendor në mes dy të afërmeve (dy të akuzuarit janë të afërm, nënat e tyre janë motra) ishte themeluar kaq qartë saqë prokurori kërkoi të ndryshohet renditja e marrjes në pyetje në

Kryetari i Trupit Gjykses: Sigurisht.

Avni Osmani: Nuk jam këtu për mëshirë, dua drejtësi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Gjykimi asnjëherë nuk mbahet me pajtimin e të akuzuarit. Neve nuk na intereson se a pajtoheni ju apo jo me gjykimin. Përndryshe nuk do të kishte kurrë gjykime në botë. Me të thënë këtë, uleni dorën dhe do ta dëgjoni dëshmitarin.

Avni Osmani: Edhe një gjë...*(ndërpritet)*

Presiding Judge: Nuk dua t'ju dëgjoj. Heshtni tani.

³ Faqe 3 e proces-verbalit : **Kryetari i Trupit Gjykses:** Në pajtim me Nenin 336, Trupi Gjykses urdhëron që Avni Osmani të largohet nga gjykata ...

Avni Osmani: Kjo është e papranueshme. Avokati Mbrojtës nuk ka të drejtë të qëndrojë në sallë të gjykimit pa autorizimin tim.

Kryetari i Trupit Gjykses: Avokati Mbrojtës e din se ka për detyrë të qëndrojë në sallë të gjykimit derisa të emërohet një avokat i ri.

Fadil Hoxha: E di. E di mirë, por me mirësi ju kërkoi të gjeni një avokat të ri dhe të më lironi sot ngase e kam shumë të vështirë të qëndroj edhe një çast më shumë. Kam respekt të madh për ju, për Trupin Gjykses. Nuk dua që një avokat të shoh në këtë mënyrë [pakuptueshëm].

*Name: Aktgjykim
Job Number: A - 980*

*Translated by: Phone:
EL
SC*

Page: 8 of 31

mënyrë që t'u shmanget ndikimi i tepërt i pranisë së Avni Osmanit në marrjen në pyetje të Fitim Breznicës⁴.

Si përmbledhje, të gjitha këto aspekte të të akuzuarit Avni Osmani ofrojnë një perspektivë homogjene të personalitetit të këtij njeriu, që mund të përshkruhet si manipuluese, pra tendencën për të përdorur të tjerët në itneres të tij. Procesi psikologjik mund të ketë manifestime të tjera dhe të përfshijë teknika të tjera, por të gjitha përfshijnë elementin itnelektual të përfaqësimit të diçka të pavërtetë për të bindur apo detyruar dikë të bëjë diçka apo të besojë në një version specifik, i cili është në favor të të akuzuarit.

Tanimë, do ta lëmë mënjanë këtë aspekt. Por në një fazë të mëvonshme, pas ekzaminimit të provave, do të jetë nevoja që t'i kthehemi sërish në mënyrë që të arrijmë në konkluzion të përgjithshëm mbi shqyrtimin kryesor dhe zhvillimin e tij.

Tanimë do të fillojmë me ekzaminimin e provave në dispozicion, deklaratat e dëshmitarëve, dokumenteve në dosje, dhe përshkrimit të fakteve nga të akuzuarit.

Në mënyrë që të bëjmë një gjë të tillë, nuk është e rëndësishme që gjërisht të përshkruhen faktet në të gjitha aspektet e tyre ngase pjesa më e madhe e fakteve nuk kundërshtohet. Ç'është e vërteta, rindërtimi i ngjarjeve nuk ka sjellur shumë kundërtënie në seanca, siç mund të shihet nga kufizimi i marrjes në pyetje nga pala tjetër të dëshmitarëve të propozuar nga prokurori dhe nga përqëndrimi në aspekte që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me sjelljen e kundërshtimeve në versionet e dëshmitarëve.

Së fundi, i vetmi që u përpoq në një rast të sjellë marrjen në pyetje nga pala tjetër në thelb të çështjes ishte vetë i akuzuari Avni Osmani, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit Shefki Zogiani, kur pyeti dëshmtiarin për arsyen e vërtetë të vizitës së tij (Avniut) në punishten e dëshmitarit⁵.

Me një ekzaminim më të thellësishëm dhe të kujdesshëm, është lehtë të shihet arsyetimi për qasjen 'e butë' të avokatit mbrojtës ndaj marrjes në pyetje të dëshmitarëve të palës tjetër.

⁴ Seanca e 1 shtatorit 2009, faqe 16: **Prokurori Publik**: Nëse mund të propozoj që ta marrim në pyetje fillimisht Fitim Breznicën dhe pastaj të akuzuarin Avni Osmani. Mbase në praninë e tij, Fitim Breznica nuk do të mund të shprehet lirshëm

Trupi Gjykues diskuton propozimin.

Kryetari i trupit gjykues: Në rregull. Trupi Gjykues pranon propozimin për të marrë në pyetje Fitim Breznicën të parin. Radhitja në aktakuzë nuk e detyron Trupin Gjykues e as Kodi nuk përmban ndonjë irradhitje të caktuar për të marrë në pyetje të akuzuarit. *Prokurori Publik ka dhënë një arsye të mirë për të marrë në pyetje fillimisht Fitim Breznicën sepse gjatë shqyrtimit kryesor është bërë e qartë se personaliteti i Avni Osmanit është shumë më i fuqishëm sesa ai i Fitim Breznicës.* Dhe për këtë arsye, do të dëgjojmë së pari Fitim Breznicën dhe pastaj Avni Osmanin.

⁵ Seanca e 29 qershorit 2009, faqe 15: **Avni Osmani**: Dëshmitari deklaroi se unë kam shkuar në punishten e tij për të riparuar ca pjesë të derës, për të porositur ca pjesë. A kam ardhur për pjesë të derës apo për të porositur ca kuti druri për të transportuar drogë?

Shefki Zogiani: Unë nuk kam gjë të bëj me drogë. Ju jeni i vetmi person që merret me drogë.

Avni Osmani: Është e vërtetë, por edhe ai (ndërpritet).....

Avni Osmani: Vetëm desha ta ballafaqoj dëshmtiarin në mënyrë që të mos mund të sillet më për këtë gjykim. Edhe një pyetje. A kemi transportuar drogë për Lulzim Pllanën?

Kjo kryesisht bazohet në konsiderimin e nuk ka prova të drejtpërdrejta të vrasjes. Përpos Avni Osmanit, i cili dha versionin e tij të fakteve, asnjëri nuk ishte në gjendje t'i referohet modaliteteve specifike të vrasjes ngase askush (përpos Osmanit) nuk ishte i pranishëm gjatë kryerjes së vrasjes së Kastriot Zogianit. Në të vërtetë, rrethana e njëjta e vrasjes së Kastriot Zogianit dhe jo vetëm zhdukjes së tij për ndonjë arsye tjetër (mungesë me vetëdëshirë, fatkeqësi natyrore, fatkeqësi në komunikacion) është supozuar dhe krijuar nga gjurmë të ndryshme, por nuk ishte e vërtetë e thënë përderisa nuk u zbulua trupi i pajetë i viktimës pas indikacioneve të dhëna nga Avni Osmani gjatë marrjes në pyetje më 16 dhjetor 2004.

Si pasojë, pjesa më e madhe e fakteve të cialve u referohen dëshmitarët nuk u kundërshtuan shumë ngase nuk ishin përmbledhje e drejtpërdrejtë e vetë vrasjes. Dëshmitarët dëshmuar mbi rrethana periferike për të cilën kontestimi nuk ishte relevant (*frustra probatur quod probatum non relevat*) apo nuk ishte i mundur. Mirëpo, sipas mendimit të Prokurorit, kompleksiteti i këtyre pjesëve të provave, marrë në tërësi jep indikacione se dy të akuzuarit kanë kryer vrasjen e Kastriot Zogianit.

Është e qartë se rasti është i bazuar në prova indirekte apo rrethimore ngase gjykata nuk ka në dispozicion prova direkte për kryerjen e krimit nga të akuzuarit.

Sigurisht se kjo nuk kufizon lirinë e teoremës së prokurorit e as nuk e zvogëlon rëndësinë e dëshmitarëve të dhëna nga dëshmitarët.

Është thjeshtë spekuluese të besohet se një rast serioz mund të zgjidhet bazuar në prova direkte.

Mund të jetë gjë e zakonshme dhe jo mendim i avokatëve me përvojë të mendohet se standarti i nevojshëm i gjyqimit i shprehur në shprehjen 'faji përtej çdo dyshimi të arsyeshëm' mund të arrihet vetëm apo ka më shumë gjasë të arrihet me kusht se ekzistojnë prova direkte për kryerjen e një krimi.

Në përgjithësi, aktiviteti kriminal nuk kryhet në mënyrë të atillë që jep prova direkte.

Është e kundërta. Përvoja na mëson se shumica e veprave penale në çdo sistem ligjor dhe në çdo vend, që nga vendet më primitive e deri në vendet më komplekse, është e bazuar në prova rrethimore, ku faktet në aktakuzë dëshmohen në mënyrë jodirekte dhe ku kërkohet që gjykatësi të vlerësojë faktet e njohura për të përcaktuar nëse akuza është e bazuar. Fundja, ky proces mendor është pjesë më se e rëndësishme e aktivitetit gjyqësor në lamië penale dhe atë civile. Vetë fjala 'jurisprudencë' kur i referohet shkencës së ligjit vënë në praktikë jep indikacione për 'prudencën', pra vlerësimin e kujdesshëm të fakteve bazuar në rregullat e përvojës është esenca e detyrës së gjykatësit. Është kjo një detyrë që kërkon nivelin e njëjtë të lartë të kujdesit kur përfshiren provat rrethimore dhe kur provat direkte gjenden para gjykatësit.

Zhvlërësimi jokritik i provave rrethore, në fund, është një perceptim i gabuar i cili duhet të refuzohet.

Duke i nënshtuar ekzaminimit tejet të hollësishëm dhe me respektndaj regullave të tjera të gjykimit, të diskutuara në jurisprudencë në gjithë botën si dhe në Kosovë (p.sh., marrja e vendimit mbi provat rrethore dhe jo direkte, Gjykata duhet të përjashtojë konkludimet e tjera, *Gjykata Supreme e Kosovës, vendimi 21 korrik 2005, Latif Gashi dhe të tjerët*) provat rrethore nuk kanë nivelin e njëjtë të besueshmërisë sikurse provat direkte.

Në rastin aktual, provat rrethore rezultojnë nga një numër relevant rrethorash të clat janë dëshmuar gjatë shqyrtimit kryesor dhe që janë të renditura mëposhtë në një mënyrë që nuk ka për qëllim të shprehë peshën e tyre relative në vendim e as nuk ka renditje të logjikshme (gjë e cila nuk mund të ekzistojë te faktet që kanë karakteristika të ndryshme dhe mund të mos kenë lidhshmëri rrjedhojash në mes vete). Rënditja në fjalë është praktike dhe ka për qëllim të vendosë faktet në perspektivë.

Gjatë shqyrtimit kryesor, lidhur me vrasjen e Kastriot Zogianit janë sjellë në sipërfaqe dy versione në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Versioni i parë është ai i prokurorit. Sipas dëshmvive, regjistrimit të telefonit dhe provave të tjera, është thënë se vrasja është kryer nga Avni Osmani (me një lloj pjesëmarrje të Fitim Breznicës) me qëllim të përvetësimit të të hollave të cilat Kastriot Zogiani kishte marrë nga ca të afërm dhe të njohur në shkëmbim për premtimin se do të punësohej në Aeroportin e Prishtinës. Sipas këtij version, Avni Osmani, i cili fillimisht kishte qenë ndërmjetësi në mes të palëve të interesuara dhe administratës së aeroportit, kishte organizuar një mashtrim në dëm të Kastriot Zogianit dhe punë-kërkuesve të tjerë. Ishte një komplot ku skena e fundit ishte vdekja e Kastriotit me qëllim që të merren të hollat dhe të fshehet roli i Avni Osmanit në kryerjen e mashtrimit. Në këtë paraqitje të ngjarjes, Fitim Breznica kishte rol ndihmës, imponuar në të nga lloji i të afërmit që ishte përgjegjësi dhe nga fati i qenies njerëzore nënshtuar vullentit despotik të kushëririt të tij.

Siç do të sqarohet gjatë pjesës së motivimit, rikonstruimi i fakteve nga Prokurori mbështetet në rrethanat në vijim:

- Motivi i fortë i Avni Osmanit

Ashtu si ishte i përfshirë në punësimin ilegal të njerëzve në administratë të aeroportit të Prishtinës, ai në një moment e kishte kuptuar se planet dhe marrëdhëniet e tij me të tjerët të përfshirë në këtë skemë po ngatërroheshin. Me eliminimin e personit ndërmjetësues në marrëveshjen për punë, ai do të ishte në gjendje të fshihte mashtrimin e punësimit.

- Fakti se Avni Osmani kishte një takim me Kastriot Zogianin në (rreth) kohën e vrasjes. Rrethana është vërtetuar, siç do të shihet më vonë, nga regjistrimi i telefonave të të dyve dhe nga deklaratat e dëshmitarëve.

- Menjëherë pasi që ka ndodhur vrasja, Avni Osmani ka thirrur për ndihmë kushërinë e tij Fitim Breznicën, duke i dorëzuar atij një revole dhe një këmishë të njoollur me gjak. Myrvete Breznica ka vërtetuar se i është kërkuar që të lajë me kujdes gjakun nga këmisha dhe gjithashtu ka vërtetuar se i ka kthyer të njëjtën këmishë, nënës së Avni Osmanit pas disa ditëve. Këmisha më vonë është konfiskuar nga policia.

- Sipas versionit të Myrvete Breznicës, Avni Osmani, posedonte çelësat e veturës së viktimës.

Është pranuar qartazi, pasi që është përsëritur nga një numër dëshmitarësh se gjatë tërë natës së 28 tetorit 2006, i akuzuari ka qenë në gjendje kritike të thyerjes nervore. Kjo gjendje e posaçme pretendohet nga Prokurori se gjen justifikimin në krimin që Avni Osmani sapo kishte kryer.

Gjërat personale të Kastriot Zogianit janë gjetur dhe konfiskuar nga policia në shtëpinë e Avni Osmanit mëngjesin e ditës së nesërme.

Natyrisht, asnjë nga elementet e përshkuara deri më tani nuk përbëjnë provë të drejtpërdrejtë të kryerjes së vrasjes nga Avni Osmani. Megjithatë, nëse mbledhen dhe merren në tërësi, ato mbështesin verzionin e Prokurorit dhe janë në mospërputhshmëri me çfarëdo sqarimi tjetër të vrasjes (e posaçërisht me atë të të akuzuarit, siç do të paraqitet më poshtë).

Versioni i dytë i fakteve vjen drejtpërdrejt nga i pandehuri Avni Osmani, i cili më shumë se një muaj e gjysmë pas 28 tetor 2004 dhe pas shumë versioneve të ndryshme, përfundimisht pranoi praninë e tij në vendngjarje në kohën e vrasjes, jo si vrasës por si viktimë, i cili fatmirësisht dhe me shumë vështirësi i iku fatit të njëjtë të Kastrioti Zogianit. Në veçanti, pas pranimit se ishte pjesë së bashku me Kastriot Zogianin, e një rrjeti që kishte të bënte me substanca narkotike përgjatë gjithë Evropës, ai tha se këta dy, në datën kritike, u rrëmbyen së bashku nga anëtarë të një grupi kriminal për largimin e fshehtë të një sasive të madhe të drogës (18 kilogramë heroinë) që u është dhënë atyre. Në këtë rast, përgjegjësi kryesor për marrjen e kësaj sasive të drogës, Kastriot Zogiani, u ekzekutua. Sipas versionit të Avniut, Fitim Breznica ishte i pranishëm gjatë rrëmbimit dhe vrasjes së Kastriot Zogianit, ai fillimisht u ndihmoi vrasësve që të mbanin Avniun dhe Kastriotin dhe pastaj, pas vrasjes së Kastriotit, përcollën Avniun në shtëpi.

Deklaratat e dëshmitarëve paraqesin një përshkrim të qartë të ngjarjeve që paraprinë datën kritike të 28 tetor 2004 gjatë shqyrtimit kryesor.

Vlen të përmendet se siç u tha më lart, dëshmitë e dëshmtiarëve nuk u kundërshtuan. Avokatët mbrotjës kohë pas kohe u janë referuar mekanizmit të paraparë me Nenin 364, KPPK për freskimin e kujteses së dëshmtiarit, i cili lëvizë nga deklarata që ka dhënë në hetuesi, por një praktikë e tillë nuk ka qenë shumë e pranishme gjatë shqyrtimit kryesor dhe në raste kur ka ndodhur, nuk ka qenë e përqëndruar në kontestimin e besueshmërisë së përgjithshme të dëshmtiarit apo për të dëmtuar dëshminë e tërë. Ky referim është përdorur me qëllim që dëshmtiari të jetë më i saktë apo të zgjedhë ca çështje të vogla kundërthënëse.

Sigurisht se e gjithë kjo është në favor të dëshmtiarëve dhe përshtimit të tyre të ngjarjeve, e cila nuk është ndikuar nga fenomeni që shpesh ndodhë gjatë gjykimeve në Kosovë, ku dëshmtiarët në gjykatë kundërshtojnë deklaratat e dhëna në polici apo prokurorori gjatë hetimeve, dhe me arsyetimin e presionit psikologjik dhe fizik që është ushtruar në ta, pretendojnë të tërheqin deklaratat që kanë dhënë.

Në thelb, gjatë shqyrtimit kryesor, dëshmtiarët kanë konfirmuar atë që kanë thënë në hetuesi dhe në prokurori që në fillim të hetimeve. Sigurisht se kjo rrethanë vërtetë konfirmon besueshmërinë e tyre dhe është në kotnast të madh me sjelljet e Avni Osmanit, të cilat përmbajnë ndryshime të komplikuar dhe të vështirë për të mbajtur në mend në versionet e dhëna.

Sa i përket kësaj pike, dhe me qëllim të vënies së fakteve në perspektivë, është e rëndësishme të ceket se babai dhe axha i viktimës Kastriot Zogiani, Mehush dhe Shefki u dëgjuan vetëm disa orë pas zhdukjes së Kastriotit. Siç mund të shihet në deklaratat e mbledhura në pjesën e dytë të dosjes, Mehushi u dëgjua ndërmjet orës 5.40 dhe 6.13 paraditen e 29 tetorit 2004. Shefki Zogiani u dëgjua në mes të orës 5.45 dhe 6.15 paradite. Anëtarët e tjerë të familjes Zogiani u dëgjuan gjatë orëve të ardhshme të ditës së njëjtë. Që të gjithë kanë dhënë deklarata konsistente dhe konfirmuese, të cilat u konfirmuan më vonë gjatë hetimeve dhe gjatë shqyrtimit kryesor, pa ndonjë devijim substancial. Poashtu është e rëndësishme të theksohet se deklaratat e mëparshme të Mehushit dhe Shefkiut sikurse edhe ato të Agronit dhe Kushtrim Zogianit ishin në formë të kompletuara dhe të përmbushur që nga fillimi pa ndonjë përpjekje apo nevojë për të fshehur detale apo për të ndërtuar një version të pavërtetë.

Në anën tjetër, kjo gjë lehtë mund të spjegohet me anë të gjendjes mendore në të cilën ishin anëtarët e familjes Zogiani në orët e para të datës 29 tetor kur ende shpresonin të gjenin të afërmin e tyre në jetë – kishin një qasje bashkëpunuese dhe të bazuar në të qenurit të hapur dhe dhënies së të gjitha detaleve që mund t'u ndihmojnë hetuesve për të gjetur Kastriotin.

Edhe Avni Osmani u dëgjua gjatë orëve të hershme (që në 6.00) të ditës pas zhdukjes së Kastriotit. Por, versioni i tij që përbëhej prej pak më shumë se gjysëm faqe, u ndryshua disa herë nga ai.

Të shohim tani, se çfarë është treguar përmes deklaratave të dëshmitarëve.

Pika e parë është se në fillim të tetorit 2004, Avni Osmani i ofroi Kastriot Zogianit punësim në Administratën e Aeroportit.

Për këtë ekzistojnë dëshmitë e babait të të ndjerit, Mehush Zogiani (dëgjuar më 4 qershor 2009), të xhaxhait Shefki Zogiani (dëgjuar më 29 qershor 2009) dhe të kushëririt Orhan Zogiani (dëgjuar më 29 qershor 2009).

Në veçanti, Shefkiu permendi se një herë në fillim të tetorit të vitit 2004 derisa po punonte në punishten e tij në Sllatina (si marangoz, i specializuar për dyer) erdhi Avni Osmani për arsye personale (riparime të derës së shtëpisë së tij). Pasi që i pandehuri ishte me uniformë, biseda ishte e lidhur me punën e Avni Osmanit në aeroport dhe mundësitë e punësimit aty⁶.

Ky aspekt kryesisht nuk kontestohet ngase i njëjti Osmani në përgjigje ndaj pyetjes së prokurorit, konfirmoi rolin e tij si ndërmjetës në rekrutimin e punëtorëve në aeroport edhe pse gjatë përgjigjes së njëjtë, ai refuzoi të njohë emrat Orhan Zogiani, Naser Meziu, Shukri dhe Besnik Sllamniku dhe Sinan Qeriqi t'u ketë ndihmuar për të gjetur punë⁷. Për më tepër, rrethana konfirmohet me dëshminë e Flakron Bajgorës (seanca e 11 gushtit 2009, faqe 20 e proces-verbalit).

Mirëpo, se pesë emrat e përmendur (Orhan Zogiani, Naser Meziu, Shukri dhe Besnik Sllamniku dhe Sinan Qeriqi) korrespondojnë me individë të tërhequr ndaj premtimit e punësimit në aeroport të Prishtinës, u konfirmua gojarisht nga individët e përmendur, të cilët si dëshmitarë në gjykatë rrëfyan detalisht dhe me fare pak ndryshime në mes të versioneve të tyre mënyrën se si ndërmjet fillimit dhe fundit të tetorit 2004, humbën të hollat e tyre për një premtim i rremë të punësimit në administratën e aeroportit të Prishtinës.

⁶ Proces-verbal, faqe 4: **Prokurori Publik:** A keni pasur ndonjë bisedë lidhur me punësimin e Kastriot Zogianit në aeroport?
Shefki Zogiani: Ai erdhi në punishten time me uniformë të aeroportit ... andaj, unë e pyeta se kur kishte filluar punën në aeroport dhe ai tha disa muaj ai vetëm permendi se do të ishte mirë sikur edhe Kastriot Zogiani të mund të punonte në aeroport
Ai vetëm tha se do të ishte mirë po të mund të punonte në aeroport. Unë i thashë se ne nuk njohim shumë njerëz në mënyrë që Kastrioti të punonte në aeroport. Avni Osmani na tha se ai njihje ca njerëz ngase disa anëtarë të UNMIK-ut jetonin në shtëpinë e xhaxhait. Pastaj shkoi dhe nuk biseduam më.

⁷Seanca e 29 nëntorit 2009, faqe 4: **Prokurori Publik:** A keni ndërmjetësuar për të punësuar ndokend në aeroport?

Avni Osmani: Po, por personat që përmenden në aktakuzë, unë kurrë nuk i kam njohur e as parë.

Prokurori Publik: A keni ndërmjetësuar për Kastriot Zogianin?

Avni Osmani: Po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet se sa keni pranuar nga Kastriot Zogiani?

Avni Osmani: 2,500 Euro, të cilat i janë kthyer në ditën e pestë apo të gjashtë, nuk jam i sigurt.

Ekziston një mori provash direkte lidhur me këto fakte, dhe këto mund të gjinden në deklaratat e dëshmitarëve në gjykatë dhe hetuesi, të cilët rrëfyan se u është afruar Kastriot Zogiani dhe i informoi lidhur me mundësinë e punësimit për një pagesë prej 3.000,00 Euro.

Ishte e qartë për dëshmitarët, viktimat e premtimit të rremë, se Kastriot Zogiani nuk ishte personi kryesor, apo me fjalë të tjera, ndërmjetësi kryesor në procedurën e punësimit. Ky detal doli si i pakundërshtueshëm nga dëshmitë e tyre edhe nëse vetëm në rastin e Orhan Zogianit ishte konfirmimi se punëtori i ardhshëm ishte i vetëdijshëm se Avni Osmani ishte krijuesi i ofertës (seanca e 29 qershorit 2009, faqe 16 dhe 17). Kjo del në mënyrë direkte edhe nga deklaratat e Shefki Zogianit dhe Mehush Zogianit. Përfundimisht, rrethana se e gjithë iniciativa e punësimit promovohet nga Avni Osmani u konfirmua me dëshminë e Flakron Bajgorës, i cili i referohet “Zhuqës” (pseudonimi i Avni Osmanit) si personi që përmendi Kastriot Zogiani si ndërmjetës për punësim në Aeroport.

Si përfundim, përrshirja e Avni Osmanit në puënsimin e Orhan Zogianit, Naser Meziut, Shukri dhe Besnik Sllamnikut dhe Sinan Qeriqit ishte mjaft e qartë dhe ishte e qartë për Mehushin, Shefki dhe Kastrioti Zogianin ngase i njëjti Avni Osmani u kishte folur për këtë çështje (të paktën Kastriotit dhe Shefkiut), por i kishte tërhuqur vërejtjen shprehimisht Kastriotit që të mos përmendte emrin e tij atyre që do të kontaktonte për punë.

Në anën tjetër, Kastriot Zogiani (sikurse edhe Metushi dhe Shefkiu) nuk kishte interes për t’u zbuluar të tjerëve emrin Avni Osmani për t’u fshehur Naser Meziut dhe të tjerëve se po punësohej me “çmim të zbritur” apo me premtimin se do të punësohej i vëllai Kushtrimi “falas”, ngase kishte gjetur edhe katër ‘klientë’ të tjerë për ndërmjetësin Osmani. Dhe nuk ishte koincidence atëherë se i vetmi që dinte emrin Avni Osmani në kohën kur bëhej ndërmjetësimi ishte i bindur se edhe Kastriot Zogiani do të paguante çmimin e plotë prej 3.000,00 euro për punësim.

Edhe nëse emrat e individëve të tjerë të përfshirë në shkëmbimin për punë dolën në sipërfaqe në pjesën e parë të hetimeve (pra Urim Zejnullahu dhe Krenar Zushi), është e qartë se pjesëmarrja personale e Avni Osmanit nuk shmangte efektin. Dhe se ai nuk ishte një prani e shtuar në proces është konfirmuar nga rrethana se ai ka vizituar disa herë punishten e Shefki Zogianit dhe shtëpinë e Mehush Zogianit lidhur me çështjen; për më tepër, ai ishte personi që nënshkroi faturën e gjetur në kuletën e Kastriot Zogianit kur pranoi shumën prej 2.500,00 euro “për një person punë në aeroport”⁸. Dhe ishte i vetmi pikë kontakti në mes të klanit Zogiani dhe administratës së aeroportit.

Nuk është e nevojshme të shpenzohet kohë lidhur me detalet për procesin e punësimit apo shumat e të hollave që u paguan për këtë nga të pestit. Të gjitha këto aspekte janë shtjelluar nga dëshmitarët pa provokuar kontestim substancial apo marrje në pyetje nga pala tjetër. Divergjencia të vogla në versione nuk mund të zvogëlojnë besueshmërinë e dëshmitarëve apo ta bëjnë qëllimisht të paqartë dhe vështirë të kuptohet rindërtimi i

⁸ Dokumenti në dosje, volumni 2.

përgjithshëm i ngjarjeve me shpërndarjen e roleve përkatëse. Fundja, siç u tha edhe nga prokurori, shqyrtimi kryesor trajton çështjen e vrasjes së rëndë dhe jo mashtrimin, i cili është trajtuar në një hetim tjetër. Në shqyrtimin aktual, mashtrimi në dëm të 6 (Kastrioti Zogiani, Orhan Zogiani, Naser Meziu, Shukri dhe Besnik Sllamniku dhe Sinan Qeriqi) gjendet në prapavijë, si skenar, i cili vetëm ndikon në motivin e krimit, viktimë e së cilës është Kastriot Zogiani. Si i tillë, mjafton që ne të kuptojmë se cili ishte roli i Avni Osmanit dhe jo ai i të tjerëve në mashtrim.

Nga dëshmitë e ndryshme është e qartë se Avni Osmani kishte rolin qendror në plan.

Është gjetur se është iniciuar një procedurë regjistrimi, apo të paktën është bërë të duket sikurse është iniciuar një gjë e tillë, me kërkesën për dokumente, siç është ajo e shëndetit dhe çertifikata shkollimi si dhe dhënia e 'begjave', distinktivëve. Prapa iniciativës, nuk ka mundur të jetë Kastriot Zogiani sigurisht ngase ai nuk kishte lidhmëri me ambientin e punës në aeroport dhe ishte jashtë kësaj bote. Është çështje tjetër sa i përket Avni Osmanit, i cili pranoi të ketë qenë i përfshirë në ndërmjetësime të tilla (seanca e 24 nëntorit 2009) dhe ishte i njohur me ambientin në aeroport për shkak të aktiviteteve të tij të punës.

Sa i përket kësaj pike të fundit, duhet të theksohet se në fund është bërë e qartë se Avni Osmani nuk ka qenë i punësuar në aeroport. Sipas informatave në dosje (raporti zyrtar i datës 2 nëntor 2004), uniforma e konfiskuar në shtëpunë e Osmanit nuk i përket stafit të aeroportit. Në linjë të njëjtë, gjatë marrjes së tij në pyetje, Avni Osmani refuzoi pretendimin e punësimit në këtë administratë dhe në pyetje të hetuesve, gjithnjë konsideronte veten si të 'papunë'.

Në anën tjetër, është e pakontestueshme se kur kishte interes, ai portretizonte veten e tij dhe aktivitetet e tij si të një punëtori të aeroportit⁹, edhe nëse me kujdes kërkonte që të mos informohej askush lidhur me punën e tij¹⁰, dhe se kur dëshironte, dilte i veshur me uniformë (shih dëshminë e Shefki Zogianit dhe atë të të fejuares Mynavere Gerguri). Çfarë peshe duhet dhënë paraqitjes së Avni Osmanit në uniformë të pavërtetë? A ishte vetëm një paraqitje fodullëku e njeriut që dëshiron të linte përshtypje të mira tek e fejuara? Sigurisht se jo. Duke paraqitur rolin e shtirur të tij në administratën e aeroportit, ai mund të rriste aftësinë e tij për të qenë ndërmjetës dhe për të ofruar punësim të tjerëve. Në fjalë të tjera, ishte pjesë e metodikës së fshehtë, të mençur dhe të padrejtë në dëm të Kastriot Zogianit dhe pesë të tjerëve.

⁹ Seanca e 29 qershorit 2009: Prokurori Publik: Çfarë pune ka kryer Avni Osmani?

Mynavere Gerguri: Unë e dija se punonte në aeroport, nuk e di me saktësi se çfarë ka punuar, por sipas meje, ishte diçka me kamera.

Prokurori Publik: A e keni parë ndonjëherë me uniformë të aeroportit?

Mynavere Gerguri: E kam parë në uniformë.

Prokurori Publik: A ju ka thënë Avni Osmani ndonjëherë të mos i thoni kujt se punon në aeroport?

Mynavere Gerguri: Në fillim po. Kishte frikë se mos humbiste punën, prandaj kërkoi të mos them gjë për këtë.

¹⁰ Përpos njërit (Orhan Zogiani), katër të tjerët (Naser Meziu, Shukri dhe Besnik Sllamniku dhe Sinan Qeriqi) konfirmuan se Kastriot Zogiani nuk u zbuloi atyre emrin e ndërmjetësit (Avni Osmani) për shkak se kjo ishte kërkesë e vetë ndërmjetësit. Në përgjigje të pyetjes së shtuar nga Gjykatësi, ata u përgjigjen duke thënë se u mjaftonte fjala e Kastriotit.

Është gjetur se pagesa është kryer nga këta pesë (Orhan Zogiani, Naser Meziu, Shukri dhe Besnik Sllamniku dhe Sinan Qeriqi) Kastriot Zogianit edhe pse këta të parët asnjëherë nuk përmendën se kur i janë dhënë të hollat pranuesit përfundimtar, Avni Osmanit. Sidoqoftë, bazuar në rolin dhe sjelljet e Avni Osmanit, në këtë përfundim të përbashkët kanë arritur të gjithë anëtarët e familjes Zogiani.

Deri në fund, asnjë ndër pesë të përmendurit nuk u ankuan ndonjëherë dhe as nuk kishin dyshime për ndonjë gjë e as nuk kishin frikë se mund të humbnin edhe të hollat edhe punën. Ishte e kundërta, kishin besim se do të punësoheshin dhe i falnin besimin 'kontaktit' të tyre Kastriotit deri në atë pikë sa që secili i besoi gjithë shumën prej 3.000,00 Euro pa kërkuar ndonjë dokument apo garancion në shkëmbim. Në anën tjetër, Kastrioti nuk ishte i vetmi në këtë pikë. Babai i tij Mehushi dhe xhaxhai Shefkiu me praninë e tyre në prapavijë kishin një rol, që duke marrë parasysh traditat e shqiptarëve, mund të kuptoheshin si garancion për seriozitetin e propozimit. Që të dy, Mehushi dhe Shefkiu u mashtruan.

Me të thënë këtë, tanimë mund të fillojmë të marrim parasysh zhvillimin e ngjarjeve në ditën kritike.

Përpos atij që e privoi nga jeta Kastriot Zogianin, individët e fundit që e panë të gjallë ishin Flakron Bajgora dhe Mehush Zogiani.

I pari, një shok shkollë i viktimës kaloi një pjesë të pasdites së 28 tetorit më të.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më 11 gusht 2009, dëshmitari sqaroi se në ditën kritike ai takoi Kastriot Zogianin dy herë, njëherë në mesditë në Fushe Kosovë për një orë dhe pastaj në mes të pasdites në Prishtinë, "në Sante, afër Agorës...prapa Elektrokosovës, ndërmjet Bulevardit Bill Klinton dhe Eletrokosovës".

Gjatë takimit të dytë, dëshmitari fillimisht jepte indikacione se pas ballafaqimit me deklaratat e tij të mëparshme¹¹, e kishte gabim. Ai fillimisht tha ndërmjet orës 4.00 – 4.20 pastaj, dhe e korrigjoi dhe tha në 5.20 pasi që iu lexua deklarata e tij më 25 janar 2005 në pajtim me Nenin 364, KPPK nga avokati Vahid Halili. Arsyetimi i korrigjimit është i logjikshëm dhe i besueshëm sa i përket referencës së kohës¹². Në këtë mënyrë, edhe deklarata e dhënë nga dëshmitari në polici më 29 tetor 2009 në orën at 12.10 konfirmohet (sipas kësaj deklarate, takimi është mbajtur në mes të orës 17.20 dhe 17.40).

Në gjykatë, dëshmitari u kujtua se çfarë ka ndodhur gjatë takimit si dhe arsyet pse Kastriot Zogiani ndërpreu takimin në mënyrë të beftë, i detyruar të pranojë një telefonatë

¹¹ Hetuesve më 29 nëntor 2004 dhe Prokurorit më 25 janar 2005.

¹² Proces-verbali i seancës së 11 gushtit 2009, faqe 21: **Flakron Bajgora**: Është e vërtetë sa i përket kohës dhe tani më kujtohet se ishte 5.20 pasdite dhe ishte Ramazan, pak para Iftarit. E di se Iftari ishte rreth orës 6.10 pasdite dhe prandaj më kujtohet se ishte rreth orës 5.20.

nga, siç iu referua bashkëbiseduesi i tij, “Zhuqa”. Që nga çasti i parë, ishte e qartë për dëshmitarin se “Zhuqa” ishte mbiemri i Avni Osmanit, ishte e qartë për të edhe e konfirmoi në fund të dëshmisë që dha në gjykatë dhe në deklaratat e dhëna në hetuesi që arsyeja e vetme që Kastrioti u largua nga kafeneja dhe e përcolli Flakronin për në shtëpi ishte urgjenca për ta takuar Avni Osmanin, së cilit kishte për t’i dhënë ca distinktivë¹³.

Provat e telefonatave ndërmjet numrit të Avni Osmanit (044 405851) dhe atij të Kastriotit (044 404233) janë në faqe 13 të listës së dhënë nga Operatori Vala me kërkesën e prokurorit. Kjo listë përmban regjistrimin e pesë telefonatave ndërmjet 17.25 dhe 17.56 nga telefoni i Avniut në atë të Kastriotit.

Siç u tha më lart, personi i fundit që pa të gjallë Kastriotin ishte babai i tij Mehushi, i cili përmendi rrethanat e tilla në deklaratën e dhënë më 4 qershor 2009.

Derisa po fliste për ngjarjet e pasditës së vonshme të datës 28 tetor 2004, ai deklaroi: *“Atë ditë ishim duke punuar në vendin tonë dhe Kushtrimi ishte me mua. Kur Kushtrimi ishte me mua dhe Kastrioti deshi të shkonte, Kushtrimi tha ta priste se po vinte me të. Kastrioti i tha se nuk kishte nevojë të vinte me të ngase Avni Osmani i kishte thënë që vetëm ai të vinte”* (faqe 15 të proces-verbalit).

Është konfirmuar se para të shkonte të takonte Avni Osmanin, Kastrioti shkoi shkurt në shtëpi pasi që e la Flakron Bajgorën në Prishtinë. Për çfarë arsye? Sigurisht për të mbledhur dokumentet që kishte për të dhënë Avni Osmanit për stampim.

Një burim tjetër (Agron Zogiani) vazhdoi të na informojë se Kastrioti e dinte që nga ora 14.30 se kishte për të takuar Avni Osmanin rreth orës 6.00 pasdite për arsye të njëjtë (në prani të dëshmitarit, Kastrioti pranoi disa thirrje telefonike nga personi Zhuqa).

Siç u tha më lart, është vërtetuar se Kastriot Zogiani kishte për të takuar Avni Osmanin më 28 tetor 2004 në orën 18.00 dikund në Sllatinë. Është e qartë se dy personat që kishin për t’u takuar kuptonin ndryshe nga njëri-tjetri arsyen e takimit. Për Kastriotin, çështja e takimit ishte formalitetet që duhej kryer për të dhënë validitetet dokumentacionit të nevojshëm për punësim në aeroport gjatë ditëve vijuese (punëtorët e ardhshëm dhe Kastrioti kishin pranuar telefonata me kërkesë për t’u paraqitur në zyrën e administratës 2 të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës të nesërmen dhe në ditët që vijonin pas kësaj – mbi këtë detal, shihni dëshmitë konvergjente të Orhan Zogianit, Naser Meziut, Shukri dhe Besnik Sllamnikut dhe Sinan Qeriqit); nuk ka mundur të jetë arsyeja e njëjtë për Avni Osmanin ngase ky e dinte se procesi i punësimit ishte vetëm një mashtrim dhe i tillë do të mbetej.

Çfarë ndodhi pastaj?

¹³ Proces-verbali i seancës 11 gushtit 2009, faqe 21: Prokurori Publik: Ju shkuat pas bisedës në mes të Kastriot Zogianit dhe Avni Osmanit. A tha Kastriot Zogiani, “më duhet të shkoj?” Flakron Bajgora: Po, sepse u nisëm së shpejti nga aty. Deklarata e 29 nëntorit 2004. (kjo pjesë është lexuar në gjykatë për të freskuar kujtesën e dëshmitarit në pajtim me Nenin 364, KPPK, dhe është konfirmuar nga gjykatësi): “Rreth orës 17.35, dikush e telefonoi atë (Kastriotin) dhe i tha ‘a do të vish në Sllatinë për të sjellur distinktivat dhe ftesat për të vulosur’. Kastrioti tha ‘do të vij menjëherë’. E pyeta se kush ishte dhe ai tha ‘Zhuqa Sllatina’.”

Name: Aktgjykim
Job Number: A - 980

Translated by: Phone:
EL
SC

Natyrisht, kjo është fushë e supozimeve, pasi në dosje nuk ka asnjë burim të qartë të dëshmive në dispozicion.

Ajo çfarë dijmë (nga Shefki Zogiani në Gjykatë, nga Kushtrim Zogiani –deklaratat e të cilëve janë lexuar në Gjykatë pas njoftimit të vazhdueshëm të dëshmitarit por pa dobi-dhe nga lista e regjistrimit të telefonatave) është se Kushtrimi ka thirrur vëllain e tij Kastriotin me telefonin e Shefkiut (044 137437) shtatë herë nga 18.59 deri 19.05. E treta nga kjo listë e thirrjeve (e regjistruar nga sistemi të jetë bërë në 19.00:05) ka marrë përgjigje; zëri i Kastriotit është dëgjuar nga Shefkiu dhe Kushtrimi, si dhe muzikë në prapavijë, duke kërkuar nga dikush t'i lejojë atij të përgjigjet në thirrje nga familja.¹⁴ Dhe ne poashtu e dijmë se çfarë ka ndodhur pastaj.

Nga deklarata e Myrvete Breznicës (motra e të akuzuarit Fitim) dhe nga regjistrimet telefonike, mësojmë se Avni Osmani ka telefonuar në linjën fikse të familjes Breznica (+381 638 580 978) tri herë, në 18.41 -10 sekonda-, në 18.56 -15 sekonda- dhe në 19.07 -25 sekonda. Mund të supozojmë se thirrja e tretë –e vetmja thirrje me kohëzgjatje të arsyeshme- është ajo të cilës Myrvetja i referohet në dëshminë e saj kur kujton se Avni Osmani ka thirrur pas Iftarit (darka gjatë kohës së Ramazanit¹⁵) në mënyrë që të udhëzojë Fitim Breznicën të vijë te hekurudha ta takojë atë.

Kjo thirrje e fundit pason për shtatë minuta thirrjen e Kushtrimit drejt telefonit të Kastriotit, kur është dëgjuar zëri i të ndjerit, duke përcaktuar kështu dy kohëzgjatjet e periudhës kohore gjatë së cilës është kryer vrasja e Kastriot Zogiani (në mes orës 19.00 dhe 19.07).

Nga sasia e elementeve të mbledhura, tashmë mund të nxirren disa përfundime.

Së pari, Fitim Breznica nuk ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes në kohën e kryerjes së krimit. Përndryshe, cila do të ishte arsyeja për të thirrur linjën fikse të familjes Breznica përpara dhe pas vrasjes?

Së dyti, koha e takimit në orën 18.00 i është dhënë Kastriot Zogianit mjaft kohë përpara (disa orë përpara: Agron Zogiani ka qenë në dijeni të takimit dhe arsyes për këtë qysh në orët e hershme të pasdites, siç është shpjeguar më herët). Nuk ka qenë diçka e planifikuar me nguti; nuk ka shenja të nxitimit apo të ndonjë kërkesë detyruese të bërë nga dikush tjetër dhe të imponuar mbi Avni Osmanin apo Kastriot Zogianin nën kërcënim të armës së zjarrit. Kjo definitivisht hudhë poshtë verzionin e dhënë nga Avni Osmani, për një bandë të shpërndarësve të drogës të udhëhequr nga Lulzim Plana dhe me një përbërje të

¹⁴ Deklarata e Kushtrim Zogianit 29 tetor 2004, në 5.50: "Leshonem, leshonem vec te foli". Procesverbali i seancës së 29 qershor 2009, fq.6: Shefki Zogiani: "...Ai ka qenë, siç thashë, në shtëpinë time sepse Kushtrimi nuk ka pasur telefon prandaj e ka përdorur timin. Pra, Kushtrimi ka bërë thirrjen dhe Kastrioti është përgjigjur. Unë kam qenë ulur përpara Kushtrimit dhe kam dëgjuar kur dikush është përgjigjur në telefon, kam dëgjuar Kastriotin duke thënë "Lëshom veç të foli". Në atë moment kam dëgjuar një zë dhe muzikë, por nuk kam mundur të besoj se po ndodhte diçka e tillë.

¹⁵ Siç u pa më parë, Flakron Bajgora ka përmendur se Iftari ka qenë në orën 18.10.

çuditshme (dy femra të reja, një mashkull i maskuar i gjatë, një mashkull me mustaqe, një polic i Kosovës).

Por, kur e kemi fjalën për verzionin përfundimtar të fakteve të dhëna nga Avni Osmani, le të themi disa fjalë të shohim se si është zhvilluar mbrojtja e të akuzuarit Avni Osmani.

Mund të numërojmë verzionet si në vijim.

I pari është dhënë nga Avni Osmani në mes të natës së 28 dhe 29 tetorit 2004, disa orë pas fillimit të kërkimit të Kastriot Zogianit nga ana e familjarëve të të ndjerit. Mehush Zogiani, në deklaratën e tij të dhënë në stacionin policor duke filluar në orën 5.40 në mëngjesin e 29 tetorit 2004 përmend se, në orët e mëhershme, gjatë natës, ai, së bashku me disa kushërinj të tij, kanë marrë në pyetje Avni Osmanin lidhur me vendndodhjen e Kastriotit. Avni Osmani është përgjigjur se ata kishin shkuar “me dy makina Golf III deri te fshati Bardh i Madh por pastaj ne (Kastrioti dhe Avniu) u ndamë dhe në Golf-in tjetër (jo Golf-in e Avniut) ka qenë një femër që sipas tij (Kastrioti, kuptohet) ishte e dashura e Enver Sekiraqës dhe poashtu dy meshkuj të tjerë, të rinj, ishin në atë makinë dhe ku kanë shkuar, unë (Avniu) nuk e di”. Se Avniu në fakt ka dhënë këtë verzion të paartikulluar dhe konfuz është konfirmuar nga Shefki Zogiani në dëshminë e tij në Gjykatë.

Verzioni i dytë është dhënë nga vetë Avni Osmani një polici në orën 6.00 në mëngjesin e 29 nëntorit 2004. Ai fillimisht ka thënë se e kishte parë Kastriot Zogianin në orën 16.00 pasdite në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë por ata atëherë shkëmbyen vetëm pershëndetje të zakonshme (si je, si po shkon). Pastaj, ai (Avniu) shkoi të marrë të fejuarën e tij te vendi i saj i punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për ta dërguar në shtëpi. Rrugës për në shtëpi makina e tij tejkalohet nga makina e Kastriotit i cili e sfidoi atë (makina e cilit ishte më e shpejtë). Por, në Bardhin e Madh, arriti edhe një Golf tjetër, i vozitur nga një femër ku brenda ishin dy femra dhe një mashkull. Kastrioti është detyruar të hyjë në makinë dhe pastaj ata u larguan nga aty. Në cilin drejtim dhe për çfarë arsye, Avniu nuk ishte në gjendje të tregojë.

I dëgjuar disa orë më vonë (në 12.00 të ditës së njëjtë), Avni Osmani përsëriti pjesën më të madhe të versionit të njëjtë. Ai iu referua pjesëmarrjes së tij në negociata për punësimin e Kastriot Zogianit, duke pranuar të ketë pasur një sërë rastesh për ta takuar në të kaluarën, por ditëve të fundit, kishte rastin vetëm të pinte kafënë së bashku me Kastriotin.

Versioni i tretë është dhënë të nesërmen, më 30 tetor në orën 15.30. Avniu tha se është kontaktuar nga Kastrioti në orët e hershme të pasdites së 28 tetorit. Kastrioti e kishte pyetur se a kishte gjë të re në procedurën e punësimit. Ata u takuan në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, secili prej tyre i shoqëruar me nga një zonjë (Mynavere Gerguri ishte me Avniun). Avniu premtoi se do të merrte informata lidhur me punën në aeroport dhe pastaj do të telefononte Kastriotin. Pastaj Avniu vazhdoi versionin e tij duke

përsëritur rrefimin e njëjtë sikurse edhe në deklaratën e mëparshme (të ditës së djeshme në orën 6.00), por më detalisht.

Pastaj paraqitet edhe versioni i katërt më 3 nëntor, një ndryshim kolosal i perspektivës. I akuzuari tregoi se në orën 17.30 të ditës kritike, diksuh erdhi në shtëpinë e tij. Ai doli te porta e oborrit për të parë se kush ishte dhe takoi Lulzim Pllanën, i cili menjëherë e detyroi të futet në një ndër dy veturat që kishin ardhur. Nxorri armën dhe e drejtoi drejt kokës së Avniut. Lulzimi mori telefonin e Avniut dhe bëri një telefonatë një personi duke thënë se ata (Lulzimi dhe personi në telefon) duhej të takoheshin te Bardh i Madh për pesë minuta. Pastaj Lulzimi e liroi atë dhe e la të ikte në shtëpi. Kur u larguan dy veturat, Avniu kontrolloi listën e thirrjeve në telefon dhe zbuloi se Lulzimi kishte telefonuar Kastriotin. Thirri sërish Kastriotin për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur, Avniu e qetësoi Kastrioti.

Deklarata e rradhës, e para në praninë e avokatit (Z.Bajram Tmava) dhe Prokurorit (Shamsi Haidini), u dha më 10 nëntor.

Gjatë dhënies së kësaj, i akuzuari kryesisht bashkoi te dy versionet në një. Në thelb, ai fillimisht ritregoi rrefimin e takimit me Kastriotin në Fakultet Ekonomik në prani të të dashurave të tyre, pastaj të garës për në Fushë Kosovë, dhe të pranisë së Golf III me dy femra të tjera dhe një të ri në Golfën në të cilin u fut Kastrioti.

Kësaj pjese të fillimit, Avniu ka shtuar se më vonë gjatë pasdites, në orën 17.30, kur ai ishte në shtëpinë e tij, kanë arritur dy vetura të tipit Opel, një Ascona dhe një Senator. Ai ka dalë jashtë për të parë se kush ishte por menjëherë është gjetur përballë Lulzim Pllanës i cili e ka detyruar të hyjë në njërin prej veturave dhe ka marrë telefonin e Avniut. Më tej e dimë se si është zhvilluar ngjarja.

Në fund, versioni i fundit i ngjarjes është dhënë me datë 16 dhjetor 2004, në praninë e Avokatit Mbrotjtës (Bajram Tmava).

Siç dihet, në këtë paraqitje të fakteve perspektiva ndryshon përsëri rrënjësisht. Këtë herë, sipas fjalëve të Avniut, ai ka qenë i pranishëm gjatë krimit por siç është thënë më parë vetëm sepse Lulzim Pllana e ka rrëmbyer atë për të shkuar tek Kastrioti. Këtë herë, Fitim Breznica ka qenë i pranishëm në vendngjarje (por i maskuar) në anën e sulmuesve. Këtë herë, historia e parave të dhëna dhe të marra për punën në aeroport, që janë përmendur në deklaratat e mëparshme dhe që deri në atë kohë kanë qenë pas motivit për rrëmbimin e mundshëm të Kastriotit, bëhet e parëndësishme dhe Avniu pranon se ka qenë pjesë e një rrethi kriminal të përfshirë në trafikim droge së bashku me Kastriotin dhe Fitimin.

Më sipër i jemi referuar pjesës tjetër të historisë dhe nuk ka arsye që t'a përsërisim. Mjafton të thuhet se i akuzuari, i dëgjuar vetëm me datë 13 maj 2005 dhe me pas gjatë një ballafaqimi me Lulzim Pllanën (dhe në fund gjatë marrjes në pyetje në Gjykatë) nuk ka ndryshuar më paraqitjen e tij të ngjarjeve, të paktën për sa i përket gjërave thelbësore.

E çfarë mund të thuhet për sjelljen e të akuzuarit i cili ka ndryshuar versionin e tij gjashtë herë? Edhe duke marrë parasysh se ekzaminimet fillestare nga policia janë bërë pa praninë e avokatit mbrojtës gjatë kohës kur i pandehuri ishte në paraburgim (pra, një rast mbrojtjeje të detyrueshme), ndryshimet e fundit të versioneve e lexuesin përpleks.

Por le të supozojmë për një moment se Avniu, i habitur se është i akuzuar, ishte konfuz, i tronditur dhe i shokuar dhe nuk ishte në gjendje të kujtohej mirë. Le të imagjinojmë se atij i është kthyer kujtesa vetëm pak a shumë një muaj pas fakteve dhe se në atë moment (16 dhjetor) ai ka dhënë deklaratën autentike.

Fakti se versioni i datës 16 dhjetor nuk konfirmohet nga asgjë dhe se përkundrazi ai përmban shumë kundërtënie.

Të shohim tani se në çfarë konsistojnë ato pikë për pikë.

Pika e parë. Avni Osmani ka thirrur Kastriot Zogianin dhe i ka kërkuar atij që t'i sjellë atij **kartelat** disa orë më parë siç është konfirmuar nga Agron Zogiani dhe Flakron Bajgora; ai nuk është thirrur nga Lulzim Pllana pak minuta përpara se të vritej, siç deklarohet në versionin e fundit. Takimi ku Kastrioti ka gjetur vdekjen është vendosur nga Zhuqa (Avni Osmani) disa orë më parë dhe jo nga Pllana pak çaste përpara se të mbahej.

Pika e dytë. Fitim Breznica nuk ka qenë i pranishëm në vendngjarje, siç është vertetuar përpara (fq.18). Çila është arsyeja e paraqitjes së Fitim Breznicës (vendosmëria modeste e të cilit, mungesa e iniciativës dhe natyra e tij e ndikueshme ishin shumë të qarta gjatë gjithë shqyrtimit kryesor) si krijues (!?) i grupit kriminal? Është e qartë se një muaj pas ngjarjes, Avni Osmani kishte kuptuar se herët a vonë Fitim Breznica do të ishte kthyer nga Shqipëria dhe do të kishte treguar versionin e tij; dhe pastaj të ishte zbuluar vendndodhja e trupit të pajetë të Kastriotit dhe do të ishte shkatërruar besueshmëria e Avni Osmanit. Ishte pra më mirë që të krijohej një skemë që përfshinte Fitimin në anën e të këqinjve dhe Avniun në anën e viktimave. Por fatkeqësisht siç është thënë, Fitimi në atë kohë ishte në shtëpi

Pika e tretë. Dëshmia e Myrvete Breznicës ka qartësuar se ishte Avniu ai që i kishte dhënë Fitim Breznicës këmishën e njollosur me gjak.

Tani, mund të mendohet se Myrvete ka dashur thjesht të mbrojë vëllain e saj kur është marrë në pyetje nga policia; kështu ajo ka shpikur një version në të cilin zvogëlohej kontributi i Fitimit, nëse ka pasur të tillë.

Kësaj konsiderate ne i përgjigjemi si në vijim.

Së pari, kur ajo është marrë në pyetje, Myrvetja nuk kishte mundësi të koordinonte versionin e saj me atë të vëllait i cili gjendej në paraburgim në Shqipëri.

Së dyti, rrethana se këmisha është larë dhe pastaj është dhënë nënës së Avni Osmanit, Hasime Osmani, e cila është motra e nënës së dëshmitarit, është konfirmuar edhe nga Hasime Osmani.

Së treti, thirrjet telefonike të bëra Fitimit nga Avniu (për të urdhëruar atë që të vijë tek hekurudha) dhe telefonatat që Mynavere Gërguri ka bërë në telefonin e Avniut (të cilin Avniu ia kishte lënë Myrvetes) janë konfirmuar nga matjet telefonike dhe nga vetë Mynaverja në deklaratën e saj.

Dhe së katërti, besueshmëria e Myrvetes ishte e qartë në Gjykatë: ajo u paraqit si një mendje shumë e thjeshtë, e frikësuar që të vijë në Gjykatë dhe pa u përpjekur asnjëherë që të ikë nga detyra e saj për të thënë të vërtetën. Ajo ka dhënë spjegime të thjeshta dhe kur gjendej në vështirësi ajo asnjëherë nuk është përpjekur që të shpikë ndonjë histori (gjë të çilën ajo nuk do të kishte qenë në gjendje të bënte). Por, në naivitetin e saj ajo është paraqitur autentike dhe e besueshme. Nëse ka bërë gabime dhe nëse ndonjëherë ajo është larguar nga deklaratat e saj e mëparshme, kjo ishte si rezultat i vështirësisë së saj për të kujtuar deklaratat fillestare dhe jo me qëllim që të gënjejë.

Pika e katërt. Blloku i Kastriot Zogianit dhe dokumente të tjera personale të të ndjerit janë sekuestruar në shtëpinë e Avni Zogianit, jo në posedim të Fitim Breznicës. Si mund të spjegohet kjo gjë? Përgjigjja e vetme, nga Avni Osmani, gjatë ekzaminimit të tij përfundimtar, e shprehur me një përzjerje habie, keqardhje dhe hezitimi, ishte se Fitimi i kishte hedhur ato nga kopshti “nën kulm të stallës...” kur ata të dy ishin kthyer nga vendi ku ishte bërë ekzekutimi i Kastriot Zogianit, duke shtuar “por nuk e di se çfarë ishte”.

Pika e pestë. Asnjë lloj prove nuk është gjetur kundër Lulzim Pllana. Nuk ka asgjë kundër tij në gjithë dosjen e lëndës përveç fjalës së Avni Osmanit. Lulzim Pllana ka kërkuar vazhdimisht (sikurse edhe Fitim Brezniça) që t’i jepej mundësia për t’u ballafaquar me akuzuesin e tij, për çudinë dhe mosbesimin e versionit akuzues.

Për aq sa ishte e mundur, Prokurori është përpjekur të verifikonte alibinë e paraqitur nga Lulzim Pllana, edhe nëse duhet të pranohet se dy dëshmitë në dosje (ajo e Beqir Pllanës dhe ajo e Azem Pllanës datë 9 janar 2005) nuk janë bindëse, në favor të Lulzim Pllanës.

Pika e gjashtë. Deklarata e Fitim Breznicës e dhënë përpara hetuesve, në prani të avokatit të tij mbrojtës dhënë me datë 30.4.2005, ditën e ekstradimit të tij nga Shqipëria, ku i akuzuari mbahej fillimisht në paraburgim për posedim dhe përdorim të dokumenteve fallco duke tentuar të shkojë në Itali dhe pastaj në bazë të një urdhër-arresti ndërkombëtar lëshuar në lidhje me pjesëmarrjen e tij të pretenduar në rrëmbimin dhe vrasjen e Kastriot Zogianit.

Ekzaminimi i të akuzuarit ka filluar në orën 22.00, dhe kjo tregon urgjencën dhe ngurrimin e hetuesve për të marrë deklaratën e Fitim Breznicës përpara se versioni i tij të mund të kontaminohet. Në atë kohë, i akuzuari nuk ka mundur të ketë kontakte me anëtarët e familjes apo ndonjë tjetër. Pra është parandaluar çdo rrezik kontaminimi apo koordinimi i versioneve.

Duke qenë kështu, paraqitja e tij e fakteve mund të shihet si autentike dhe nëse jo plotësisht e besueshme (mund të ketë pasur dhe në fakt ka disa gabime dhe gjëra të

paplotësuar) ajo është e vlefshme në thelb dhe e besueshme. Kështu, i akuzuari nuk ishte në atë kohë në gjendje që të dinte se çfarë kishin thënë hetuesve dëshmitarët e tjerë (për shembull, motra e tij Myrvete apo e fejuara e Avniut, Mynavere).

Duke u nisur nga kjo nuk është e rëndësishme se përshkrimi i fakteve nga Fitim Brezniça korrespondon dhe mbulon paraqitjen e fakteve nga motra e tij Myrvete në veçanti lidhur me detajet mbi thirrjen telefonike të bërë nga Avni Osmani pas Iftarit dhe mbi dhënjën nga i akuzuari të sendeve dhe këmishës së njetosur me gjak. Në detajin kryesor të dorëzimit të këmishës Fitim Breznicës, duke kërkuar që Myrvetja t'a pastronte vërehet se i dyshuari, gjatë nje pjese të madhe të marrjes në pyetje nuk e ka përmendur këtë dhe vetëm një pyetje e parashtruar nga Prokurori ka lejuar të dyshuarit që të përqëndrohet në këtë detaj dhe të elaborojë atë. Është e qartë të konsiderohet se nëse deklarata e të dyshuarit do të kishte qenë fiktive dhe e koordinuar me motrën, tregimi i një elementi faktik të tillë, themelor për identifikimin e përgjegjësive penale e atij që kishte dorëzuar këmishën duke kërkuar që ajo të lahej, do të ishte vënë në fillim të historisë dhe nuk do të ishte harruar.

Në të njëjtën vijë mendimi, përcaktimi qartësisht i gabuar i rrjedhës së ngjarjeve në paraqitjen e Fitimit është tregues i një kujtese të gabuar të ngjarjeve dhe jo një provë e pararenditjes së versionit dhe koordinimit të tij me versionin e dikujt tjetër. Kështu, kur Fitim Breznica deklaroi se, pas takimit me Avni Osmanin dhe marrjes së këmishës dhe pistoletës, ai është kthyer në shtëpi dhe Avni Osmani është larguar dhe është kthyer në shtëpinë e Fitimit vetëm pas dy orësh, ai bën një përballje të qartë të ngjarjeve që janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me versionin e dhënë nga motra e tij Myrvete. Edhe në këtë rast ky është një tregues i mungesës së koordinimit të versioneve mes vëllait dhe motrës dhe pra tregues vertetësie.

Pika e shtatë. Nuk ka asnjë element në dosjen e lëndës që konfirmon apo të paktën sugjeron se kishte ndonjë lloj marrëdhënie mes Fitim Breznicës dhe Kastriot Zogianit, lidhur me anëtarësinë e tyre të pretenduar në një grup kriminelësh të përfshirë në trafikim droge siç ka deklaruar Avni Osmani, në të cilin Avniu dhe Kastrioti (dhe Shefki Zogiani, siç është përpjekur të deklarojë Avni Osmani gjatë marrjes në pyetje nga pala tjetër të vetë Shefkisë¹⁶) do të ishin transportues të drogës dhe Fitim Brezniça mbledhësi. Duke filluar nga vetë Fitim Breznica deri tek anëtarët e familjes Zogiani dhe Mynavete Gërguri të gjithë përjashtojnë ekzistencën e një marrëdhënie të tillë. Të dy (Fitimi dhe Kastrioti) ishin thjesht të huaj për njëri tjetrin dhe nuk kishin të bëjnë fare me njëri tjetrin.

Akuza e Avniut në dëm të kushëririt të tij Fitim (ata janë djem tezes) është thjesht një tregues i cinizmit dhe dëshpërimit të Avni Osmanit i cili nuk heziton të akuzojë të afërmin e tij në vend që të marrë vetë përgjegjësitë e tij.

¹⁶ Seanca e datës 29 qershor 2009, fq.15: Avni Osmani: Dëshmitari deklaroi se kam shkuar në punishten e tij për të bërë disa pjesë të derës, për të porositur disa pjesë. A kam ardhur për pjesë të derës apo për të porositur disa kuti druri për të transportuar drogë?...

Shefki Zogiani: Nuk kam fare lidhje me drogë. Ju jeni i personi i vetëm që merreni me drogë.

Avni Osmani: Kjo është e vërtetë por gjithashtu ai ka (ndërpritet).....

Avni Osmani: Desha vetëm të ballafaqoj dëshmitarin me qëllim që ai të mos sillte më këtu për këtë lëndë. Edhe një pyetje, ne kemi transportuar drogë për llogari të Lulzim Pllanës.

I njëjti mosbesim qëndron për pretendimet e pjesëmarrjes së Kastriot Zogianit në një grup kriminal. Viktima është përshkruar nga të anëtarët e familjes si një i ri i ndershëm, një anëtar i mirë i familjes. Të pesë të cilët i kishin dhënë atij para me qëllim që ai të rekrutohej në punë në aeroport kanë konfirmuar se ata kanë vepruar kështu sepse kishin besim në të dhe pyetjes së çfarë dinin ata rreth kushteve të punës në aeroport (rroga, posti, orari i punës), ata janë përgjigjur duke thënë se kjo nuk ishte e rëndësishme sepse ata kishin besim tek Kastrioti dhe se fjala e të riut Zogiani ishte e mjaftueshme për ta. Në anën tjetër, e njëjta rrethanë se anëtarët e familjes Zogiani ishin të shqetësuar dhe se ata kishin filluar të kërkonin Kastriotin përpara orës 7.00 të pasdites me 28 tetor sepse ishte e pazakontë që ai të rrinte jashtë kaq gjatë (në realitet kishte vetëm një orë që ai ishte larguar nga shtëpia) dhe të mos kthehej në shtëpi për drekë (në veççanti gjatë Ramazanit), është një tregues i qartë i kontrollit të familjes mbi Kastriotin dhe zakonet e tij gjë e cila e bën me të vërtetë të pabesueshme se ai mund të ishte një trafikant narkotikësh.

Elemente të tjerë mund të merren parasysh dhe të peshohen në vlerësimin e gjithë provave të lëndës. I referohemi këtu dëshmisë së Mynavere Gergurit apo pyetjes lidhur me faktin se pse familja Zogiani kishte identifikuar menjëherë Avniun si kryerës i asaj që ata tashmë kishin kuptuar se ishte rast vrasje dhe jo thjesht rrëmbim apo zhdukje e vullnetshme e viktimës. Apo arsyes pse Avni Osmani është dukur të gjithëve si jashtëzakonisht i stresuar dhe nervoz, sikur të kishte haluçinacione, nga mbremja e datës 28 tetor deri në ditën në vijim.

Por, analizimi i këtyre aspekteve është i parëndësishëm sepse elementet kundër Avni Osmanit për kryerjen e vrasjes së Kastriot Zogianit tashmë janë vërtetuar.

Kështu, për shëmbull, analiza e deklaratës së Mynavere Gergurit, e cila përgënjeshtroi fjalët e Avni Osmanit në shumë aspekte (veshja e uniformës dhe punësimi në aeroport; mbajtja dhe shfaqja e armës nga Avni; takimi me Kastriot Zogianin dhe gara me makina në rrugën Fushë Kosovë që pohon Avniun të cilën Mynavete Gërguri e përjashtoi; etja e Avniut për para) bëhet e panevojshme.

Vlen të kthehemi tek një pikë që është përmendur më parë.

Në faqen 20, me qëllim që të paraqitet përgënjeshtrimi i versionit të fundit të dhënë nga Avni Osmani, kemi paraqitur këtë çështje duke u bazuar në një supozim.

Ne kemi shkruar: *“Por le të supozojmë për një çast se Avni, i habitur që është nën akuzë, ishte konfuz, i tronditur dhe i shokuar dhe nuk ishte në gjendje të kujtohej mirë. Le të imagjinojmë se atij i është kthyer kujtesa vetëm rreth një muaj pas fakteve dhe se në atë moment (16 dhjetor) ai ka dhënë deklaratën e vërtetë”.*

Ky është një supozim i madh në favor të të akuzuarit dhe ka ardhur koha tani të verifikojmë nëse kjo gjë ka ndonjë kuptim.

Është e besueshme se një gjendje e tillë psikologjike ka ekzistuar në mendjen e Avni Osmanit në orët menjëherë pas vrasjes së Kastriotit, e cila ka krijuar një humbje të ndërgjegjes dhe një çrregullim të aftësisë së akuzuarit për tu kujtuar, pra një gjendje konfuzioni dhe turbullimi, duke e bërë atë të paaftë për të dhënë një paraqitje të besueshme të ngjarjes atyre që e kanë marrë në pyetje dhe në veçanti anëtarëve të familjes Zogiani dhe oficerëve të policisë? Gjithashtu, a është e besueshme që kjo gjendje e një shqetësimi të tmerrshëm të thellë të ketë zgjatur disa ditë dhe më shumë se një muaj dhe të jetë zhdukur vetëm në mes të muajit dhjetor kur në fund Avni Osmani bëhet përsëri *compos sui* dhe ishte në gjendje të thotë të vërtetën?

Nuk është e nevojshme të kesh një diplomë të nivelit master në psikologji dhe nuk kërkon një sofistikim intelektual të madh për të kuptuar se versionet e ndryshme të dhëna nga Anvi Osmani nuk janë pasojë e një gjendje mendore të veçantë por janë më shumë një tentative e vullnetshme për të mashtruar hetimet dhe për të larguar dyshimet ndaj tij.

Sikurse ai të kishte qenë viktimë e rrëmbimit dhe të kishte ndihmuar në ekzekutimin e shokut të tij Kastriot, përse ai nuk do të kishte thënë të vërtetën? Sigurisht që ai do të kishte qenë i shokuar (pas një përvoje mendore kaq shkatërruese) por reagimi i parë do të kishte qenë që ai të distancohet nga vrasja e neveritshme. Dhe jo të vijë me një version e cila aludon në praninë e shokëve të Enver Sekiraqës (në atë kohë një kriminel shumë i njohur në Kosovë që më vonë është bërë i turpshëm për pjesëmarrjen e tij në vrasjen e një oficeri me famë të policisë, Triumf Riza)? Sikurse ai të kishte akuzuar kryerësit e vërtetë menjëherë, ai do të kishte qenë i besueshëm tani.

Është vërtet e panjohur dhe kundërshton përvojën më themelore fakti se një gjendje mendore e turbullt mund të arrijë deri në pikën sa të shtyjë personin që vuan këtë të shpikë një version, të gënjejë. Gënjeshtat konsistojnë në deklarata të pavërteta dhe mashtruese të përdorura me paramendim për të mashtruar. Ekziston një element thelbësor i qëllimit në gënjeshtër që nuk mund të gjejë justifikim nëse supozohet një gjendje mendore shoku. Me fjalë të tjera, Avni Osmani do të mund të kishte qenë i besueshëm sikurse të kishte qëndruar në heshtje apo sikur të kishte pasur qëllimin që të mos mund të kujtohej, sikur të kishte thënë se kishte një boshllëk në kujtesë duke bërë që ngjarjet të mos regjistrohen në kujtesën e tij. Një gjendje e tillë është një efekt psikologjik i njohur që ndodh shpesh në rast të një aksidenti me makinë apo ndonjë ngjarje të tjetër të ngjashme. Në fakt ndodh që i/e mbijetuari/a të thotë shpesh se ai/a jo nuk është në gjendje të kujtojë momentet e fundit përpara impaktit. Është një mekanizëm mendor që krijon shkëputje të kujtesës së shkurtër në përpjekje (kjo justifikohet gjerësisht nga ekspertët e kësaj fushe) për të kursyer viktimën nga vuajtja jashtëzakonisht e rëndë për të kujtuar çastin e frikshëm që ka shkaktuar plagët. Është një vetëmbrojtje e mendjes, një qetësues që parandalon zbulimin e mundshëm të të vërtetave të padurueshme.

Por në rastin e Avni Osmanit kemi paraqitjen e një serie versionesh gjithnjë e më të elaboruara që kanë për qëllim krijimin e një perdyje ndarëse në pjesëmarrjen e tij në fakte. Fillimisht ai ka përgënjeshtuar të ketë pasur takim me Kastriotin duke pretenduar se

Kastrioti kishte shkuar diku me një makinë Golf së bashku me tre individë të tjerë (dy zonja dhe një djalë i ri); pastaj Avni Osmani paraqet versionin ku Lulzim Pllana vjen në shtëpinë e tij dhe nën kërcënimin e armës, duke vjedhur telefonin e tij (të Avniut) vetëm për të bërë një telefonatë Kastriotit. Pastaj, versioni i fundit që përfshin edhe Fitim Breznicën.

Po pse gjithë këto ndryshime? Qartësisht sepse Avni, me kalimin e kohës, ka kuptuar se ecuria e hetimeve do të kishte shkatërruar brishtësinë e versioneve fillestare. Në momentin kur ai ka kuptuar se regjistrimi i thirrjeve telefonike do të kishin zbuluar nivelin e shkëmbimit të thirrjeve telefonike mes telefonit të tij dhe atij të Kastriotit ai është detyruar që të përfshijë në histori edhe dikë tjetër (Lulzim Pllanën) i cili ka marrur me forcë telefonin e tij (të Avniut) për të thirrur Kastriotin dhe për ta ftuar atë në takim dhe vdekjes. Dhe ai ka bërë këtë duke thënë diçka krejt qesharake sepse nuk mund të pranohet se ekziston qoftë edhe një arsye për të çilën Lulzim Pllana do të kishte shkuar në shtëpinë e Avniut vetëm për të bërë një telefonatë Kastriotit duke rrezikuar në këtë mënyrë që të zbulonte planin e tij për të vrarë Kastriotin përpara se ta ekzekutonte atë. Dihet se në Kosovë kartelat SIM mund të blihen në qoshe të rrugës, pra Lulzim Pllana nuk do të kishte pasur asnjë vështirësi për të blerë një të tillë nëse ai donte të bënte një telefonatë të pagjurmueshme Kastriotit.

Dhe pastaj, kur Avni ka kuptuar se kthimi i Fitim Breznicës nga Shqipëria do të kishte çmontuar historinë e tij, ai ka nxjerrë versionin e tij të fundit me pjesëmarrjen e Fitim Breznicës në rrëmbimin dhe vrasjen e Kastriotit. Me pasojën e pashmangshme, në atë moment, se ai duhej të zbulonte vendin ku ishte kryer vrasja.

Në këtë perspektivë, bëhet e qartë se procesi mendor i Avniut nuk ishte një rigjetje progresive e kujtesës apo e ndërgjegjes. Nuk ishte një lloj purifikimi përmes së cilit mendja pastron vetveten dhe lirohet nga faji i kryer.

Ishte e kundërta, një hap tjetër në uljen e moralit të individit ku, i humbur se i humbur, nuk ka kufi për paturpësi dhe çdo gjë mund të shitet në një përpjekje të dëshpëruar për të shpëtuar vetveten nga përgjegjësia penale.

Asnjë inat, asnjë pendim apo kalim në një fazë të re të pranimit të fajit por vazhdim i qëllimit kriminal fillestar.

Kjo është arsyeja për të cilën nuk ka hapësirë për të pranuar ndonjë rrethanë lehtësuese në caktimin e masës ndëshkuese.

Modalitetet e vrasjes ishin mashtruese. Nga mënyra si viktimja është tërhequr në vendngjarje (me arsyen për të vënë edhe një vulë në dokumentet e punësimit) me qëllim që vritej në mënyrë brutale, rrethana rënduese e paraparë nga neni 147 paragrafi 1, n 3 e KPK-së është e pranishme.

Siç është thënë më parë, vetë vrasja është kryer në përpjekje për të fshehur kryerjen e krimit të mashtrimit në dëm të personave që njihnin Kastriot Zogianin. Në perceptimin e

Avni Osmanit, eliminimi i Kastriotit do të parandalonte viktimën e mashtrimit që të zbulonte pjesëmarrjen e tij (të Avniut) në këtë mashtrim.

Gjithashtu, në këtë mënyrë ekziston kushti i paraparë nga Beni 147, paragrafi 1, n.8 i KPK-së.

Në të kundërtën, pamundësia praktike për të ditur se ku kanë përfunduar paratë e dhëna Kastriotit (edhe pse konkluzioni i qartë është se këto para kanë shkuar plotësisht apo pjesërisht tek Avni Osmani), bën të vështirë konfigurimin e rrethanës rënduese nga nr 3 i paragrafit 1 të Nenit 147 të KPK-së.

Ka ardhur koha tani t'i kthehemi një çështjeje që është paraqitur në fillim të motivimit e cila ka të bëjë me tipin e personalitetit që paraqet Avni Osmani.

Ai është një njeri inteligjent por me një tendencë për manipulim dhe një intolerancë për kufijtë dhe rregullat të cilat situata, ligji dhe shoqëria imponojnë ndaj individit.

Tani mund të arrijmë në përfundimin se motivimi ka konfirmuar përshtypjet fillestare. Shqyrtimi kryesor dhe provat e sjellura përpara gjykatës, siç është ilustruar deri tani, tregojnë sipas mendimit të trupit gjykues, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, përgjegjësinë penale të Avni Osmanit për vrasjen me të cilën ngarkohet. Megjithatë, gjatë shqyrtimit kryesor, me teknikën e ndryshimit të versioneve, me kërkesën për të ndryshuar gjyqtarët dhe, kur kjo u pranua, me kërkesën për të ndryshuar prokurorin dhe në fund me pengimin pambarim të procedurës, ai është përpjekur të manipulojë rezultatin e shqyrtimit kryesor me qëllim që t'i shmanget pohimit të përgjegjësisë së tij penale.

I akuzuari ka shfaqur të njëjtën sjellje të dykuptimtë me policinë: oficerët e policisë Shamshi Jashari dhe Bujar Gashi kanë dokumentuar mirë në deklaratat e tyre respektive, llojin e marrëdhënies që Avni Osmani ka tentuar të krijojë me oficerët e policisë: një përzierje lajkash, kërkesë për mbrojtje, arrogancë (kur për shembull ai pret që të sillet në klinikën Galaxy), agresivitet dhe mbi të gjitha pengim.

Para se të kalojmë në shqyrtimin rastit të Fitim Breznicës, është një pikë tjetër që vlen të përmendet.

Gjatë rrjedhës së hetimit, atëherë kur është treguar skena e krimit nga i akuzuari, Avni Osmani, dhe kur është gjetur trupi i Kastriot Zogianit, janë bërë dy ekzaminime të ndryshme teknike, nga dy ekspert të ndryshëm të caktuar sipas kërkesës së Prokurorit.

Një ekspertizë *post mortem* dhe një ballistike janë paraqitur në kohë të ndryshme gjatë rrjedhës së hetimeve.

Dy dokumentet (dhe shtesat e tyre përkatëse), nëse gjithashtu janë profesionalisht të dukshme, kanë kufijtë e tyre, pasi që ato nuk mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në rikonstruimin e fakteve.

Nëse gjithashtu mund të tregojnë disa aspekte interesante (për raportin e autopsisë, numrin e plagëve dhe një tregues të qartë të trajektores së hyrjes së plumbave: për raportin e balistikës vetëm përshkrimin e plumbave të gjetur në dy vende, aty ku Kastriot Zogiani është gjuajtur dhe tëhequr), të dy dokumentet nuk janë bindës apo përfundimtar në përcaktimin e modaliteteve të gjuajtjes apo të numrit të njerëzve që kanë kontribuar në kryerjen e vrasjes.

Siç është konfirmuar nga të njëjtët ekspertë Tefik Gashi gjatë ekzaminimit të tij, se mundësia praktike të gjindet ndonjë element kuptimplotë për hetimin është përjashtuar nga gjendja e prishjes së trupit, i cili kishte mbetur në ujë dhe ekspozuar elementeve për më tepër se një muaj e gjysmë.

Gjithashtu nga raporti i balistikës, fakti se arma që ishte përdorur për të shtënë nuk është gjetur asnjëherë dhe se skena e krimit ka ofruar tregues të përgjithshëm, që përputhen me një mori të rikonstruimeve, nënkupton në fakt se ndihma teknike është e limituar, nëse mund të konsiderohet e tillë, dhe jo vendimtare.

Për këto arsye Kolegji mendon se ekzaminimi i gjërë i dy raporteve nuk është i nevojshëm.

Në përfundim, rasti i Fitim Breznicës.

Siç është parë, provat e pjesëmarrjes së tij në vrasjen e Kastriot Zogiani nuk ekzistojnë. Përveç fjalëve të Avni Osmani, i cili i ka rezervuar atij rolin e personit të maskuar i pranishëm në vrasjen e Kastriot Zogiani, nuk ekziston asnjë lloj prove që mund të krijojë një lidhje mes vrasjes dhe Fitim Breznicës.

Është e paspjegueshme se pse ai do të kishte marrë pjesë në vrasjen e një personi të cilin ai nuk e njihnte pa pasur asnjë lloj dije mbi marrëdhëniet mes familjes Zogiani dhe Avni Osmanit si dhe negociatat për punësimin e njerëzve në aeroport.

Pjesëmarrja e tij në ngjarjet e natës kufizohet në fshehjen e trupit të Kastriot Zogianit pas kryerjes së vrasjes.

I vetmi burim informacioni rreth kësaj është dëshmia e të njëjtit Fitim Breznica, e cila konfirmohet pjesërisht nga deklarata e motrës së tij Myrvete.

Deklarata e Fitim Breznicës dhe ajo e Myrvete Breznicës janë pranuar si të besueshme sepse motra dhe vëllai janë dukur të besueshëm gjatë shqyrtimit kryesor edhe pse këta të

dy kanë pasur role të ndryshme. Ata janë shfaqur si dy individë të thjeshtë dhe naivë pa u përpjekur asnjëherë në të vërtetë që të ikin nga përgjegjësitë e tyre.

Bazuar në këtë, përgjegjësia e vetme penale që mund të vertetohet ndaj Fitim Breznicës konsiston në shkeljen e nenit 305, paragrafi 3 i KPK-së, për dhënien e ndihmës Avni Osmanit, pas kryerjes së vrasjes së Kastriot Zogianit. Ndihmë që është dhënë në fshehjen e kufomës së viktimës dhe hedhja e armës së përdorur nga Avni Osmani për të vrarë Kastriot Zogianin.

Ndryshimi i akuzës, nga vrasje e rëndë (neni 147 KPK) në dhënien e ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale (neni.305 KPK) është lejuar në këtë rast nga ligji. Neni 386 i KPPK-së parasheh këtë mundësi nëse akti në akuzë të re gjendet në përshkrimin e akuzës së mëparshme, pra që nuk është surprizë për të akuzuarin.

Trupi Gjykues beson se fjalët e fundit të akuzës së paraqitur fillimisht, me përshkrimin e aktit të fshehjes së trupit të pajetë, në një gropë, me përshkrimin e përmasave dhe mënyrës së mbulimit, është i mjaftueshëm për të plotësuar dispozitën ligjore.

Përsa i përket përcaktimit të dënimit, në lidhje me Avni Osmanin dhe bazuar në konsideratat e shprehura më lart mbi natyrën rrënqethëse të kimit dhe sjelljen e neveritshme të të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale dhe gjatë zhvillimit të hetimeve (përfshirjen e njerëzve të pafajshme dhe ngarkimin me përgjegjësi kushëritit të tij të afërt) Trupi Gjykues përcakton se në pajtim me Nenin 37 të Kodit Penal të Kosovës dhe Nenit 147, paragrafi 1, pika (3) dhe (8) i akuzuari Avni Osmani dënohet me tridhjetë vjet burgim;

Në lidhje me Fitim Breznica, duke patur parasysh rolin e tij modest në faktet dhe varësinë e tij ndaj vendimeve të kushëritit të tij, burgimi mund të kufizohet në katër vjet dhe shtatë muaj;

Koha të cilën të akuzuarit kanë kaluar në paraburgim llogaritet si pjesë e dënimit me burgim në pajtim me Nenin 73 , KPK.

Shpenzimet e procedurës

Në pajtim me Nenin 102, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) personat e dënuar paguajnë së bashku shpenzimet e procedurës në shumën prej 400 Eurosh.



Data: 30 nëntor 2009

Kryetari i Trupit Gjykses
Francesco Florit

Anëtar i Trupit Gjykses
Marije Ademi

Anëtar i Trupit Gjykses
Dragomir Yordanov

Proces- mbajtëse
Patricia Faltusova